

Dr. Hejthem Talat

Islami dhe ateizmi ballë për ballë

Instituti Germa

Titulli i origjinalit:
Islam and Atheism face to face

Autor:
Dr. Hejthem Talat

Përktheu:
Gëzim Zeqiri

Redaktor gjuhësor:
Jeton Koqinaj

Redaktor profesional:
Jusuf Kastrati

Kopertina:
Fatlum Zeka

Botoi:
Instituti Germa

Copyright © Instituti Germa

Dr. Hejthem Talat

Islami dhe ateizmi ballë për ballë

PYETJE DHE PËRGJIGJE

Në emër të Allahut. Të gjitha lavdërimet janë për Allahun, ndërsa paqja, mëshira dhe bekimi i Tij qoftë për të Dërguarin, familjen, shokët dhe miqtë e tij!

Ky libërth është titulluar: “Islami dhe ateizmi ballë për ballë” dhe ofron një shpjegim të domethënies së ateizmit, aspektet problematike të tij dhe si i kundërshton faktet e arsyeshme, të padiskutueshme dhe të disponueshme. Po ashtu, libri prezanton një pjesë të evidencave që dëshmojnë ekzistencën e Krijuesit të Lartësuar.

Në të vërtetë, ne e njohim Allahun e Plotfuqishëm nëpërmjet arsyes. Allahu thotë: **“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!”** [Surja et-Tur: 35]

Duke përdorur arsyen, mund të themi se ekzistojnë vetëm tri mundësi (e s’ka të katërt).

E para: Njerëzit janë krijuar pa Krijues (janë krijuar nga askush), gjë që është e pamundur; si mund të ketë krijim pa pasur Krijues?

E dyta: Njerëzit kanë krijuar vetveten (ose kanë qenë krijuesit e vetvetes). Kjo, po ashtu është e pamundshme, sepse si mund të krijojë dikush vetveten përpara se të ishte i krijuar?

Prandaj, mbetet vetëm mundësia e tretë, të cilën vargjet fisnike nuk e kanë përmendur, duke pasur parasysh që është e vetëkuptueshme, domethënë, është Krijuesi Ai që na ka krijuar ne.

Pra, ne e njohim Allahun nëpërmjet arsyes dhe dispozitave natyrale. Ne e dimë në mënyrë natyrale se idolët dhe natyra janë të paaftë për të krijuar universin ose të sjellin në jetë bakteret dhe njerëzit ose të rregullojnë funksionimin e trupit të njeriut në atë mënyrë që e ka, ose që të sjellin në ekzistencë një krijim të tillë, nga atomi deri në një galaktikë.

Idolët, të cilët jobesimtarët i adhurojnë dhe natyra të cilën ateistët e besojnë, që të dy kanë nevojë për një Krijues i Cili i krijon ata. Ata nuk kanë asnjë kontroll për punët e tyre e as mund të rregullojnë hormonet e trupit të njerëzve në mënyrë të përsosur. Ata janë të paaftë që të furnizojnë çdo qelizë të gjallë me kodin gjenetik, i cili përmban miliona pjesë të informacionit. Ata nuk mund të sjellin asgjë në ekzistencë, madje as vetveten.

Krijuesi i kësaj bote, me të gjitha mrekullitë e Tij, është Krijues i Cili është i Gjithëdijshtëm, i Plotfuqishëm, i Lartësuar qoftë Ai!

Ky libërth diskuton më tutje akuzat keqdashëse të cilat i përdorin ateistët, si dhe përpjekjen e tyre për të shndërruar dëshmitë logjike dhe provat natyrale të ekzistencës së Krijuesit në një falsitet.

Më e famshmjia nga kjo përpjekje është pretendimi i tyre se universi është shfaqur në mënyrë të rastësishme. Kjo vjen si pasojë e mungesës së të kuptuarit të tyre, ose si pasojë e injorimit të parimeve bazë të probabilitetit. Kjo është kështu sepse rastësia i ka dy kushte të domosdoshme: kohën dhe vendin.

Koha është kusht për rastësinë që të sjellë përpara efektet e saj. Po ashtu, rastësia ka nevojë për një mjedis material në të cilin mund të prodhojë ndikimin e saj.

Si mund të thuhet se rastësia ka pasur rol në sjelljen në jetë të universit, ndërsa universi ka dalë nga aty ku nuk ka pasur as kohë as vend? Rrjedhimisht, koncepti i rastësisë mund të përjashtohet.

Pastaj, ky libërth prezanton disa dëshmi intelektuale në lidhje me nevojën për religjion, për kuptimin e religjionit dhe nevojën për t'iu dorëzuar e për t'iu nënshtruar Zotit të botëve. Në fakt, nënshtrimi ndaj Allahut dhe dorëzimi tek Ai përmes bindjes është esenca e fesë.

Ju i nënshtroheni Allahut dhe adhuroni Krijuesin tuaj, Furnizuesin dhe Dhuruesin e të gjitha bekimeve, favoreve dhe udhëzimeve.

Adhurimi është detyrë e robërve ndaj Allahut, meqenëse është Ai i Cili i ka krijuar ata nga asgjëja, u ka dhënë jetë dhe furnizim, i ka udhëzuar dhe ka dërguar profetë për të na testuar se cili jemi

në të vërtetë më i mirë se tjetri, kështu që adhurimi është e drejtë e Allahut.

“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.” [Surja el-Mulk: 2]

Më tutje, ky libërth do të japë disa dëshmi për vërtetësinë e Islamit dhe do të nënvizojë faktin se Allahu nuk pranon nga njerëzit asnjë fe tjetër përpos Islamit.

Allahu thotë: **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”** [Surja Al-Imran: 85]

Islami është feja të cilën Allahu e ka dërguar te të gjithë të dërguarit e Tij. Karakteristika kryesore e Islamit është se e ka kuptimin e nënshtrimit ndaj Allahut dhe adhurimin e Tij, vetëm të Tij. Përtej kësaj, Islami është ligji më i përsosur që urdhëron nënshtrimin ndaj Allahut dhe është feja e vetme që thërret në njëzimin e Allahut, gjë që është predikuar nga të gjithë profetët.

Të gjithë profetët e kishin pranuar besimin monoteist, megjithëse ligjet e tyre ishin të ndryshme.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: “S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!”** [Surja el-Enbija: 25]

Nuk ka fe tjetër në botë që ende e mban këtë besim monoteist, përpos Islamit. Të gjithë ndjekësit e religjioneve të tjera kanë rënë në nivele të ndryshme të politeizmit. Pas vdekjes së profetëve që i lanë njerëzit në besim monoteist, ata (njerëzit) eventualisht filluan të bien në politeizëm. Në kohën e sotme, Islami është feja e vetme që e mban besimin e pastër monoteist të cilin e kishin predikuar të gjithë profetët.

Pastaj, në fund, ky libërth jep një përshkrim se si njeriu bëhet musliman si dhe një shpjegim të kuptimit të Islamit dhe nevojën thelbësore të njerëzimit për këtë fe. Në fakt, Islami u përgjigjet të gjitha pyetjeve esenciale të cilat çdo njeri i ka në mendje, si: nga kemi ardhur?, pse jemi këtu në këtë botë? dhe: nga do të shkojmë?

Islami u përgjigjet të gjitha këtyre pyetjeve në vetëm një varg të Kuranit të shenjtë, ku Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: **“Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?!”** [Surja Jasin: 22]

Prej nga kam ardhur unë? Allahu më ka krijuar mua (është Ai i Cili më ka krijuar).

Ku do të shkoj unë? Do të shkoj tek Allahu dhe do të jap llogari (të gjykohe) për veprat e mia (dhe tek Ai do të kthehem të gjithë ne).

Pse kam ardhur në këtë botë? Për ta adhuruar Allahun dhe për t’u sprovuar.

Pse e adhuroj Allahun? Është e natyrshme të adhurohet Allahu i Cili më ka krijuar mua prej asgjësë. Kjo është natyra sipas së cilës duhet të jetë lidhja mes robit dhe Zotit, pra, të adhurohet Zoti, Krijuesi. (Pse nuk do të duhej të adhuroja atë që më ka krijuar mua?!)

Ky është vetëm një nga vargjet që përgjigjet në të tri pyetjet dhe që mahnit njerëzimin. **“Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?!”** [Surja Jasin: 22]

Islami është ligji i Allahut për botën. Kjo fe do të thotë nënshtrim ndaj Allahut dhe dorëzim tek Ai përmes adhurimit; rob do të duhej të kthehej te Krijuesi dhe Ruajtësi i tij.

Allahu i Plotfuqishëm thotë: **“Kush i dorëzohet Allahut, me tërë qenien e tij, duke qenë punëmirë, ai është kapur për vegën më të fortë. Tek Allahu do të kthehet çdo gjë.”** [Surja Lukman: 22]

Prandaj, Islami do të thotë shërbim për Allahun në çështjet e mëdha dhe të vogla të jetës. Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: **“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.”** [Surja el-Enam: 162-163]

Lutja ime, sakrificat ime, jeta dhe vdekja ime, të gjitha janë për Allahun, Zotin e botëve. Gjithçka që bëj, e bëj për Allahun. I lutem Allahut, u bindem prindërve për hir të Allahut, mësoj dhe studioj në mënyrë që njerëzit të përfitojnë nga unë për hir të

Allahut, natën fle që të zgjohem me energji të mjaftueshme për të bërë atë që më urdhëron Allahu. Pra, shërbimi për Allahun në secilën vepër është një nga shenjat dhe manifestimet më domethënëse të dorëzimit tek Allahu. Asgjë përpos Islamit nuk mund ta ngopë urinë për dituri rreth gjërave që na preokupojnë më së shumti, përderisa ateizmi jep vetëm njohuri joadekuate për dikë i cili e di se ka lindur për të vdekur.

Ky libërth përfaqëson njohuri dhe diskutim intelektual që adreson aspektet problematike të ateizmit dhe, po ashtu, jep disa dëshmi të vërtetësisë së Islamit. Është në formatin pyetje-përgjigje, kështu që le të fillojmë me lejen e Allahut.

1. Cili është kuptimi i ateizmit?

Përgjigjja: Ateizëm është të mos pranosh besimin në çfarëdo fuqie që nuk shihet. Një ateist e mohon ekzistencën e Krijuesit, profecive dhe ringjalljen (pas vdekjes).

2. Për çka e kritikoni ateizmin?

Përgjigjja: Ateizmi kërkon një nivel shumë të lartë besimi, nivel që drastikisht e tejkalon besimin fetar.

Përkundrazi, është një besim që bazohet në premisa të rreme dhe imagjinatë të gabuar, ndryshe nga besimi fetar që bazohet në fakte të vetëkuptueshme intuitive dhe të padiskutueshme, të cilat ne i shohim me sytë tanë, si dhe në të vërteta intelektuale e dëshmi të besueshme.

Pra, për të qenë një ateist duhet të imagjinoni sikur në vijim:

A - Universi ishte një produkt i një kombinimi të asgjësë, i cili përfundoi duke u bërë i mahnitshëm, univers i mrekullueshëm që përputhet me masat më të sakta dhe kufijtë delikatë.

B - Koincidenca prodhoi kufijtë delikatë dhe konstantet fizike në të cilat u formua universi. Kjo bie ndesh me faktin se ekzistojnë dy kushte që të ndodhë rastësia: vendi dhe koha. Por, ata pretendojnë se universi u shfaq nga askund dhe nga asnjë kohë, gjë që mohon konceptin e rastësisë.

C – Rastësia, së bashku me mjedisin parësor të tokës, prodhoi jetë, baktere dhe njerëz, edhe pse mendja e tashme njerëzore, me gjithë fuqinë e saj të plotë, nuk është ende në gjendje të prodhojë format më të thjeshta të jetës.

D-Të gjitha vlerat etike të cilat ne i konsiderojmë si të vlefshme, kryesisht bien ndesh me materializmin, pasi etika e mirëfilltë përfaqëson një peshë materiale dhe humbje të interesit të kësaj bote; këto janë faktet e dhëna dhe pasojë e materializmit. Ju duhet të besoni në të gjitha këto të pamundshme, në mënyrë që të filloni të bëheni një ateist.

E - Në ateizëm, nuk ka asnjë autoritet intelektual ose material që parandalon asgjësimin e gjithë njerëzve në tokë.

Në fakt, bota materiale nuk e njeh të drejtën dhe të gabuarën, kështu që nga pikëpamja e ateizmit, të mbash gjallë të gjithë njerëzit në tokë, ose t'i shfarosësh të gjithë ata, nuk ka asnjë dallim. Ky këndvështrim ateist është po ashtu i bazuar në besim, por pa ndonjë pikë të diturisë, prova tekstuale, intelektuale ose etike.

3. Cila është dëshmia e ekzistencës së Krijuesit?

Përgjigjja: Ka shumë dëshmi, por ne do të prezantojmë vetëm dy nga ato:

Dëshmia e nxjerrjes në ekzistencë.

Dëshmia e perfeksionit dhe përcaktimit.

4. Çka do të thotë dëshmia për nxjerrjen në ekzistencë?

Përgjigjja: Do të thotë se gjithçka që erdhi në ekzistencë, pasi ishte joekzistente, duhet të ketë një entitet që e ka shkaktuar atë që të ekzistojë dhe të bëhet e gjallë.

Në këtë mënyrë, ne kemi një numër të pakufizuar dëshmish për ekzistencën e Krijuesit, i Lartësuar qoftë Ai! Çdo atom në univers është dëshmi e krijimit, pasi çdo gjë e krijuar që ka ardhur në ekzistencë është në vetvete një provë e ekzistimit të Krijuesit.

Kur mendoni mbi ekzistencën, ju e kuptoni se ajo është e përkohshme dhe do të ndryshojë; nuk është e përhershme ose e përjetshme. Kështu, ajo nuk mund të jetë e vetëmjaftueshme. Kjo duhet t'ju bëjë të besoni me vendosmëri në mendjen tuaj se ka një Krijues; kështu që, sapo shikoni në univers, mendja ju shkon tek ai që e solli atë në ekzistencë.

Mu për këtë, ka shumë vargje në Kuran që na sjellin në vëmendje universin dhe gjërat që ekzistojnë përreth nesh.

Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: **“Thuaj: “Shikoni ç’ka në qiej dhe në Tokë!” Por shenjat dhe qortimet nuk u bëjnë kurrfarë dobie njerëzve që nuk besojnë...”** [Surja Junus: 101]

Allahu ka thënë gjithashtu: **“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? Allahu ka krijuar qiejt e Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar. E, me të vërtetë, shumica e njerëzve nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre.”** [Surja er-Rrum: 8]

Allahu ka thënë gjithashtu: **“A nuk e shohin ata mbretërinë e qiejve e të Tokës dhe gjithçka që ka krijuar Allahu, duke menduar se mund t’u jetë afruar fundi?! Në çfarë shpalljeje tjetër do të besojnë pas kësaj?!”** [Surja el-Araf: 185]

Pra, çdo gjë e krijuar është dëshmi e drejtpërdrejtë për ekzistencën e Krijuesit.

5. Çka do të thotë dëshmia e perfeksionit dhe përcaktimit?

Përgjigjja: Do të thotë gjithçka që ekziston, duke filluar nga kuarkët - grimca nënatomike më e vogël e zbuluar që formon materien - deri te galaktikat, mbart një shkallë kompleksiteti funksional.

Me fjalë të tjera, çdo gjë kryen një detyrë specifike dhe të caktuar.

Çdo kompleksitet funksional në natyrë është një status që tejkalon ekzistencën e thjeshtë. Për ta sqaruar, ekzistenca është një nivel dhe kompleksiteti i asaj që ekziston është në një nivel që e tejkalon vetë ekzistencën.

Gjithçka rreth jush është dizajnuar posaçërisht për të kryer një funksion specifik. Kjo do të thotë se gjithçka rreth jush mbart një kompleksitet funksional, gjë që është një dëshmi e krijimit dhe e sjelljes së gjërave në ekzistencë.

Pra, duhet të ketë një Krijues që i ka sjellë në ekzistencë.

Shembull i kësaj është llamba elektrike, që përfaqëson kompleksitetin funksional, pasi përbëhet prej:

1- Filamentit.

2- Një teli i cili përçon elektricitetin në filament.

3- Gazit inert që mbron filamentin pa ndërvepruar me të ose me energjinë elektrike.

4- Llambë qelqi që pengon hyrjen e ajrit dhe daljen e gazit inert nga llamba, sepse ashtu do të digjej filamentit.

5-Bazës së llambës: lidh llambën me mbajtësen dhe formon një shteg për rrymën elektrike.

Është një sistem kompleks që nuk mund të thjeshtohet, prandaj ka një konotacion të dukshëm intelektual që tregon përsosurinë e ndërtimit.

Ai që mohon ekzistencën e krijimit të përsosur të llambës elektrike ose pretendon se ajo ka ardhur thjesht rastësisht, duhet të paraqesë dëshmitë për këtë pretendim!

Prodhuesi i llambës e di mirë se çfarë është energjia elektrike, si rrugëton ajo, përfitimet e llambës dhe ndjeshmërinë e filamentit. Prandaj, ekzistenca e llambës tregon drejtpërdrejt se ajo ka një prodhues të aftë dhe se nuk është shfaqur rastësisht, thjesht sepse ka llamba të tjera që duken krejtësisht të ndryshme.

Duke përdorur të njëjtin konkluzion intelektual, ne shohim qeniet njerëzore që janë funksionalisht komplekse dhe duhet të kenë një Krijues që i ka krijuar ata.

Përderisa llamba elektrike përbëhet prej pesë komponentësh, një qenie njerëzore përbëhet prej katër miliardë përbërësish në çdo qelizë të trupit.

Katër miliardë komponentë përbëjnë funksionet e organizmit, të cilat quhen: kodi gjenetik, gjenomi ose ADN-ja dhe të gjitha këto janë të vendosura në bërthamën e secilës prej qelizave tuaja.

Pra, nëse besoni se pesë komponentët që formojnë llambën elektrike kanë një krijues, ndërsa ju nuk keni, atëherë kjo do të ishte problematike për veten tuaj.

“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!” [Surja et-Tur: 35]

Në çdo gjë rreth jush ka kompleksitet. Nuk çdo gjë që gjendet në natyrë; në atom, orbita, ose në vetë trupin tuaj ka një lloj kompleksiteti funksional.

Ai kompleksitet funksional i çdo atomi dhe grimce ekziston në gjithçka që gjendet në univers.

Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”** [Surja el-Bekare: 164]

Ka shumë vargje për këtë çështje. Sidoqoftë, vetëm ata që përdorin arsyen, i vërejnë këto. **“Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.”** [Surja Al-Imran: 7]

Kur dikush përdor mendjen e tij dhe shikon ekzistencën (evidencën e sjelljes në ekzistencë) dhe sodit saktësinë e funksionet e qenieve të krijuara (dëshmia e providencës dhe përsosurisë), sigurisht që nëpërmjet arsyes do të pranojë ekzistencën e Krijuesit.

6. Pse nuk ka mundësi që njeriu dhe organizmat e tjerë të jenë krijuar nga qenie tejet të thjeshta dhe primitive njëqelizore?

Këtu ka dy probleme:

Problemi i parë: Nuk ka asnjë provë të vetme që vërteton shndërrimin e një lloj organizmi në një lloj tjetër, e lëre më një kërcim kaq të madh që supozon kinse njeriu e ka origjinën nga qenie primitive njëqelizore.

Pra, si mund të besojë një ateist në një supozim të tillë të cilit i mungon çdo lloj prove e drejtpërdrejtë dhe të na fajësojë ne për përdorimin e konkluzioneve intelektuale fetare?

Problemi i dytë: Sipas konceptit të Grupit Minimal të Gjeneve, nuk është e mundur që asnjë organizëm, sado i thjeshtë të jetë, që të ketë më pak se dyqind gjene. Grupi minimal i gjeneve është numri më i vogël i gjeneve me të cilat një organizëm mund të jetojë.

Kjo do të thotë se, nëse këtij grupi minimal i mungon vetëm një gjen, atëherë organizmi nuk do të mund të jetojë.

Një gjen është një shirit informacioni që përmban një numër të madh kodesh gjenetike që kodojnë informacionin.

Ekziston një numër minimal i gjeneve që janë thelbësore për një organizëm për të jetuar: disa gjene janë të koduara për energji, - në fakt një organizëm nuk mund të jetojë pa energji, - ndërsa gjenet e tjera janë të koduara për ushqimin, të tjerat për riprodhimin, të tjerat për funksionet themelore të jetës, e kështu me radhë.

Shkencëtarët kanë llogaritur numrin minimal të gjeneve që janë thelbësore për jetën dhe kanë vendosur që ato nuk mund të jenë më pak se dyqind.

Instituti Craig Venter arriti në përfundimin se numri minimal i gjeneve nuk mund të jetë më pak se treqind e tetëdhjetë e dy sosh.¹ Shkencëtarët zbuluan se mykoplasma, i cili është organizmi më i vogël në tokë, ka 468 gjene.

Nëse gjithë çështja ka të bëjë me materien dhe bota është thjesht një sistem fizik, atëherë duhet të fillojmë nga gjeni zero, nëse duam të kalojmë nga hidrogjeni te njeriu!

Megjithatë, shkenca na thotë se nuk ka asgjë që quhet gjeni zero, një gjen, ose edhe njëqind gjene. Përkundrazi, shkenca thotë se

¹ J. Craig Venter Institute (JCVI) conducted a study to find all the essential genes of *M. genitalium* through global transposon mutagenesis. As a result they found that 382 out of 482 protein coding genes were essential.

ne kemi nevojë për një grup gjigant informacioni në intervalin minimal, përndryshe organizmi i gjallë nuk do të ishte shfaqur.

Në natyrë, nuk ka asgjë primitive, por çdo sistem ka filluar me një efekt të pavarur! Ky efekt në sistemin e informacionit, i cili kodon qeniet para se të shfaqen, do të mbetet gjithmonë një pengesë në përballje me ateizmin dhe për ata që mohojnë krijimin hyjnor!

Ju keni katër miliardë pjesë të specializuara informacioni brenda bërthamës së secilës prej qelizave tuaja, për të prodhuar funksione të përpikta biologjike.

Ateistët spekulonin se kishte qenie të gjalla që kishin filluar nga gjeni zero, por pastaj erdhi teoria e gjeneve minimale dhe e eliminoi këtë fantazi.

Në fakt, organizmat u shfaqën funksionalisht të ndërlikuar që në momentin e parë, përndryshe nuk do të ishin shfaqur fare.

7. Cilët janë disa nga shembujt e dëshmive të perfeksionit?

Përgjigjja: Ka shembuj të panumërt dhe të shumtë për t'u theksuar.

“Sikur të gjithë drurët, që gjenden në Tokë, të ishin pena e deti bojë shkrimi e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” [Surja Lukman: 27]

Çdo atom në univers është një tregues i providencës hyjnore, një fakt që, sot a nesër, do ta njohim.

A-Insulina, - hormoni i tretjes së glukozës, - sekretohet nga pankreasi me të njëjtën sasi sipas nivelit të marrjes së sheqerit.

B-Forca e pompimit të gjakut të zemrës është e barabartë me energjinë e nevojshme për muskujt, në përputhje me përpjekjen e ushtruar.

C-Ka valvula në stomak që parandalojnë që ushqimi të kthehet në gojën tuaj, gjë që do t'ju dëmtonte.

D- Valvulat e nxjerrjes funksionojnë në atë mënyrë që rrobat e tua të mos ndoten në çdo moment.

E-Kockat e kafkës sate nuk përzihen mes vete derisa të dalësh lehtësisht nga barku i nënës, sepse, po të përziheshin, nuk do të dilje nga barku i nënës derisa të thyheshin kockat mes vete. Gjithashtu, këto kocka nuk rriten plotësisht derisa truri juaj të rritet.

F-Të gjitha nyjat e nervave të tua që transmetojnë sinjale elektrike janë të veshura me një shtresë izoluese, - siç bëjmë ne tani me telat elektrikë, - në mënyrë që sinjali elektrik të mos humbasë e të mos shkaktojë shqetësim.

G-Elektroni rrotullohet rreth bërthamës me një shpejtësi prej një mijë kilometrash në sekondë, përndryshe do të binte brenda bërthamës për shkak të forcës së tërheqjes me bërthamën pozitive dhe universi do të përmysej para se të fillonte. Kjo shpejtësi është ideale për formimin e atomit.

H-Kur bashkohen dy atome hidrogjeni, 0.007% e masës së hidrogjenit shndërrohet në energji. Nëse masa do të ishte 0.006% në vend të 0.007%, protoni nuk do të përzihej me neutronin dhe gjithë universi do të mbetej vetëm si hidrogjen, kështu që edhe pjesa tjetër e elementeve nuk do të shfaqeshin. Nëse masa e shndërruar në energji do të ishte 0.008% në vend të 0.007%, bashkimi do të ishte shumë i shpejtë, gjë që do të çonte në zhdukjen e menjëhershme të hidrogjenit nga universi, duke e bërë jetën të pamundur. Kështu, numri duhet të jetë ndërmjet 0.006% dhe 0.008%.

I-Masa e elektronit përfaqëson 0.2% të masës së neutronit. Kjo është masa standarde për formimin e një atomi.

J-Pas mbirjes, filizat drejtohen drejtpërsëdrejti nga burimi i dritës dhe rrënjët shkojnë poshtë, meqë filizat janë jashtëzakonisht të ndjeshme ndaj dritës dhe të gjitha informacionet që u nevojiten për të bërë punën e tyre janë të koduara brenda farës. Aty janë

hormonet që kontrollojnë rritjen e sipërme dhe anësore të bimës dhe rritjen e rrënjëve. Të gjitha këto hormone janë gjithashtu të koduara brenda farës.

K- Ndërsa ju hani një frutë të shijshme dhe pastaj e hidhni farën e thatë dhe pa shije, ju e lejoni atë frutë të përcjellë gjenet e veta. Një frutë e tillë ju jep një shije të mirë, ndërkohë që i fsheh gjenet e tij, - origjinën e jetës së tij, - brenda farës së thatë që nuk ju tërheq për ta ngrënë. Pasi ta hidhni këtë farë në tokë dhe në rast se janë kushtet e përshtatshme, ajo fillon të formojë një pemë frutore me degë, degëza dhe rrënjë. E gjithë kjo ndodh në bimët të cilat nuk kanë perceptim për asgjë.

L-Kush e vendosi informacionin në atë frutë që nuk flet, që është e shurdhër dhe kush e rregulloi sasinë e sheqerit që ajo përmban, në mënyrë që të bëhet tërheqëse për ju?

Kush e bëri farën të papranueshme dhe të papëlqyeshme për ngrënie, në mënyrë që të mos keni interes dhe ta hidhni atë?

Kush e mbushi farën me informacion të mjaftueshëm gjenetik për të krijuar një bimë të re me të gjitha detajet dhe funksionet e saj?

M-Kohët e fundit kemi kuptuar se inercia, në lumturinë e së cilës jetojmë, është produkt i masës së universit në tërësi.

Çfarë do të thotë inerci?

Çfarë ju ndodh kur jeni duke hipur në një makinë dhe ajo ndalon papritur?

Ju shtyheni përpara! A është e vërtetë kjo?

Kjo është inercia.

Nëse inercia e botës sonë do të ishte më e vogël sesa është tani, fryma më e thjeshtë e ajrit do të mund të lëvizte gurët dhe, në një botë si kjo, ne do të ishim të goditur vazhdimisht nga të gjitha llojet e gjërave!

Në anën tjetër, nëse do të ishte inercia më e madhe sesa që është tani, nuk do të mund të lëviznim as gishtat tanë.²

Forca inerciale varet nga masa.

Gjëja që i habiti fizikanët është se masa e Rrugës së Qumështit, galaktika që përmban sistemin tonë diellor, merr pjesë në kontrollin e inercisë me vetëm 0.1 milion, ndërsa masa e Tokës kontrollon inercinë me vetëm 0.001 milion.

Kështu, pasojat e inercisë ideale, sipas të mirave të të cilave jetojmë dhe përmes të cilave ne kryejmë të gjitha aktivitetet tona, është produkt i energjisë totale të universit si tërësi.

² Nature's Destiny: How the Laws of Biology Reveal Purpose in the Universe, Michael Denton.

“Ne nuk e kemi krijuar kot qiellin, Tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre. Kjo është hamendja e jobsimtarëve; prandaj mjerë jobsimtarët kur të hidhen në Zjarr!” [Surja Sad: 27]

Sa më shumë që zgjerohet shkenca, aq më shumë shfaqen mrekullitë e mençurisë dhe hollësive të krijimit!³

N-Atëherë, le të flasim për syrin, këtë bekim të paçmuar. **“A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy.”** [Surja el-Beled:8]

Rezolucioni i syrit është i barabartë me pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mega-pikselë.

Syri ka thjerrëzën më të pastër në botë.

Madhësia e fotoreceptorit në retinë nuk kalon gjysmë milimetri katror dhe veçohet për dhjetë milionë nuanca ngjyrash me dimensione të ndryshme. Është me të vërtetë një krijim hyjnor i mrekullueshëm dhe i ndritshëm.

Kur shikoni diçka para jush dhe drita bie në retinë, pikërisht në atë moment ndodhin disa procese kimike komplekse dhe eventualisht gjenerojnë një rrymë elektrike. Kjo rrymë transmetohet nga retina e syrit tuaj në tru përmes lidhjeve nervore. Me këtë rast, truri e interpreton frekuencën e kësaj rryme elektrike si shikim, sikurse truri të kishte pasur një fjalor

³ Kjo çështje është diskutuar hollësisht nga Michael Danton në librin e tij: The Fate of Nature.

të integruar, i cili e konverton rrymën elektrike në aktin e shikimit të asaj që është para jush.

Kjo është diçka e mahnitshme, nëse e mendoni mirë!

Përfytyroni: ky tru qëndron brenda një kutie të errët të rrethuar nga kockat, brenda kafkës.

Asgjë nuk e arrin atë, përveç rrymave elektrike.

Pra, si mund të interpretojë truri rryma të tilla sikurse një shikim?

Si ju jep truri aftësinë për të parë?

Kjo mrekulli ndodh sapo hapni sytë dhe shikoni!

E njëjta gjë vlen edhe për dëgjimin:

Ndërsa valët e zërit hyjnë në daullen tuaj të veshit, ajo i shndërron ato në një lëvizje mekanike. Kjo lëvizje mekanike më pas transmetohet përmes tri kockave të vogla në veshin e mesëm dhe pastaj në veshin e brendshëm, i cili e shndërron atë në një rrymë elektrike.

Në këtë moment, kjo rrymë elektrike transmetohet nga veshi i brendshëm në tru, i cili fillon ta përcaktojë këtë rrymë elektrike si tingull, kështu që ju dëgjoni tingullin.

Të gjitha këto ndodhin brenda më pak sesa një pjesë e sekondës. **“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.”** [Surja en-Nahël: 78]

Përpiquni të përfytyroni se, në çdo moment, mijëra sinjale elektrike, të cilat arrijnë në tru nga syri, veshi, prekja, shijimi, nuhatja dhe pjesë të tjera të trupit, truri është i aftë për të dalluar të gjitha këto sinjale me një saktësi mahnitëse.

“Ky është krijimi i Allahut! Më tregoni çfarë kanë krijuar të tjerët pos Tij? Asgjë, por keqbërësit janë vërtet në humbje të plotë.” [Surja Lukman: 11]

“E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë. Ai di mirë çdo gjë që bëni ju.” [Surja en-Nemël: 88]

Kush është ai që mund të perceptojë plotësisht qoftë dhe një bekim nga bekimet e Allahut?

Mendoni rreth çdo nyje dhe kocke në trupin tuaj që ju mundëson të lëvizni saktësisht sipas nevojës.

Mendoni për nyjat që ju mundësojnë të lëvizni pa fërkime midis kockave ose pa erozion. Allahu ka depozituar në këto nyja një lëng i cili është sikurse lubrifikanti që vendoset në nyjat e makinave!

Mendo për bekimet e Allahut me meditim dhe bëhu falënderues ndaj Tij për to.

Bekimet e Allahut janë të panumërta!

“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t’i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E megjithatë,

disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyese dhe pa libër ndriçues.” [Surja Lukman: 20]

8. Disa ateistë e kritikojnë evidencën e përsosurisë, duke pretenduar se ekzistojnë papërsosuri sikurse sëmundjet dhe tërmetet.

Përgjigjja: Mungesa e gjërave të përsosura në univers, (sipas fjalëve të një ateisti) nuk e mohon ekzistencën e përsosurisë.

Megjithatë, duke thënë këtë, ateisti në të vërtetë e konfirmon se ka përsosuri në univers. Nëse nuk do të kishte përsosuri në radhë të parë, ai nuk do të ishte në gjendje të kuptonte ekzistencën e papërsosurisë.

Si mund të flitet për një defekt në një krijim, në një botë ku mungon krijimi?

Sa i përket asaj që ata e përshkruajnë si të papërsosur, kjo është me të vërtetë mungesë njohurie ose dështim për të perceptuar mençurinë e gjërave.

Besimtarët nuk pretendojnë se universi është tepër i përsosur për të pasur ngjarje katastrofike, por ata thonë se universi është krijuar në mënyrë të përsosur, kështu që asgjë nuk ndodh në të pa ndonjë qëllim.

Qëndrimi i një ateisti është i ngjashëm me ata që mohojnë zotërimin e anijes kozmike, sepse ka një sasi të madhe nafte në të, që mund ta bëjnë të shpërthejë në çdo çast.⁴

Bota nuk është krijuar për të qenë e përjetshme ose e përhershme, e as ne jemi krijuar për të qenë zota.

Ne jemi krijuar për t'u testuar me të mirën dhe të keqen. **”Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.”** [Surja el-Enbija: 35]

E mira, e keqja dhe të gjitha sprovat rrotullohen brenda kornizës së urtësisë dhe vullnetit hyjnor.

⁴ Dhahiratu nakdi ed-din fil-felsefeti el-haditheh, dr. Sultan el-Umejri (temë doktorate).

9. Çfarë e pengon ekzistencën e një shkaktari material që krijoi universin, siç është një qytetërim tjetër ose diçka tjetër? Pse duhet të ekzistojë në mënyrë specifike një Zot i përjetshëm?

Përgjigjja: Ekziston një rregull i vendosur nga dijetarët muslimanë më shumë se një mijë vjet më parë, që thotë: “Sekuenca e aktorëve medoemos çon në mosbërjen e veprimeve.”⁵

Sekuenca e aktorëve do të thotë se ka më shumë se një krijues. Pyetja në fjalë përmend “një qytetërim tjetër”, që paraprihet nga një qytetërim që e ka prodhuar atë dhe një qytetërim që i ka paraprirë dhe prodhuar të dy etj. Kjo përfaqëson sekuencën e krijimit, e cila medoemos është e favorshme për mosbërjen e veprimeve, përkatësisht mosshfaqja e qenieve të krijuara, si: universi, njeriu dhe të tjerët.

Sekuenca e aktorëve rezulton në mosshfaqjen e universit dhe ekzistencës. Nëse një qytetërim varet nga ekzistenca e një qytetërimi tjetër që e ka krijuar atë dhe qytetërimi tjetër varet nga një qytetërim tjetër që e parapriu dhe e krijoi atë, e kështu me radhë deri në pafundësi, atëherë as ky qytetërim, as ai që i paraprin, as ai që u paraprin të dyjave nuk do të shfaqej. Pra, nuk do të shfaqej as ekzistenca, asgjë nuk do të shfaqej, sepse, nëse çdo qytetërim varet nga një qytetërim tjetër që i ka paraprirë,

⁵ Dhahiratu nakdi ed-din fil-felsefeti el-haditheh, dr. Sultan el-Umejri (temë doktorate).

nuk do të shfaqej asnjë qytetërim dhe asgjë nuk do të ekzistonte kurrë.

Pra, duhet të ketë një Krijues të parë të Përjetshëm që krijoi gjithçka!

Nëse ka një sekuencë të pafundme dhe çdo hallkë në zinxhir varet nga ajo para tij, atëherë nuk do të kishte krijesa, asnjë krijim, asnjë qenie, sepse agjenti do të varej nga një agjent që i paraprin dhe më pas do të varej paraardhësi i tij në një të mëparshëm, etj., prandaj nuk do të kishte asgjë.

Pra, sekuenca duhet të ndalet diku.

Këtu bëhemi të sigurt për krijuesin e parë që nuk i paraprin asgjë tjetër!

10. Ne i dimë ligjet e universit, e dimë edhe shkaktarin e tërmeteve. Pse kemi nevojë për një Krijues përderisa ne i dimë ligjet e natyrës?

Përgjigjja: Një ateist supozon se ligjet janë të mjaftueshme për të krijuar universin dhe për ta bërë atë që të shfaqet. Disa ateistë janë mbështetur në idenë e ligjit të gravitetit dhe se ai është i mjaftueshëm për shfaqjen e universit, pavarësisht se ky pretendim shkatërrohet thjesht duke e marrë parasysh burimin e ligjit të gravitetit, ose kur mendojmë se kush e kodifikoi atë ose kush i dha atij vetinë e interferencës dhe të shfaqjes së efektit. Pavarësisht këtyre intuitave të vetëkuptueshme, ligji i gravitetit nuk bën që asnjë top bilardoje që të rrotullohet e lëre më që të shkaktojë diçka pa shfaqjen e asaj gjëje!

Ligji i gravitetit nuk mund të prodhojë një top të bilardos, ai thjesht e bën atë të lëvizë nëse është i krijuar dhe goditet nga një shkop i bilardos.

Në fakt, ligji i gravitetit nuk është i pavarur, por është një përshkrim i një dukurie natyrore.

Për më tepër, ligji i gravitetit nuk do të lëvizë topin e bilardos pa një forcë që shtyn shkopin e bilardos dhe e lëviz atë. Vetëm në këtë moment, topi i bilardos lëviz dhe shfaqet efekti i ligjit të gravitetit.

Megjithatë, një ateist supozon se ligji i gravitetit është i mjaftueshëm për të krijuar topin e shkopin e bilardos dhe për të rrotulluar topin!

Cila është më afër arsyes dhe logjikës së mirë në lidhje me shkakun e shfaqjes së universit: Krijuesi apo ligji?

Në mënyrë të ngjashme, ligjet e djegies së brendshme të një motori makine nuk mund të krijojnë një motor makine.

Nëse motorit të makinës i vendosim vetëm ligjet e djegies së brendshme, as në këtë rast nuk do të funksionojë. Aty duhet të ketë benzinë që jep energji dhe duhet të ketë një shkëndijë për djegie, si dhe paraprakisht të ketë motor. Vetëm pas kësaj do të funksiononin ligjet e djegies së brendshme dhe do të punonte edhe motori!

Pra, nuk është e arsyeshme të mendojmë se ligjet e djegies së brendshme janë të mjaftueshme për të krijuar motorin, shkëndijën e djegies, benzinën, shoferin dhe rrugën.

Në fakt, ideja se një ligj është i mjaftueshëm për të shpjeguar shfaqjen e universit është një ide që është krejtësisht e papranueshme për arsyen.

Përveç kësaj, nëse e mendojmë këtë ide, ajo do të na çojë në sekuencën e aktorëve që shpjegojmë në përgjigjen e pyetjes së mëparshme, lidhur me atë se kush e krijoi ligjin dhe kush e solli në ekzistencë atë. Nëse ata pretendojnë se është një ligj tjetër,

ne do të futemi në sekuencën e aktorëve që sjellin mosshfaqjen e ndonjë ligji ose ndonjë qenieje.

11. Pse rastësia nuk mund të jetë burim i universit?

Përgjigjja: Të adoptosh idenë e rastësisë është mosnjohje e fundamentit të mundësive, duke pasur parasysh faktin se rastësia ka dy kushte të domosdoshme, të quajtura: koha dhe vendi.

Rastësia specifikon një kohë kur e bën efektin e saj dhe përcakton ekzistencën e një vendi material ku prodhon ndikimin e saj.

Atëherë, si mund të themi se rastësia ka luajtur një rol në krijimin e universit, edhe pse universi ynë u krijua kur nuk kishte kohë dhe vend?

Si mund të shfaqet efekti i rastësisë pa shfaqjen e vetë rastësisë?

Si ka mundësi që rastësia të japë një efekt përpara ekzistencës së saj ose ekzistencës së kohës dhe vendit, të cilat janë dy kushtet thelbësore të rastësisë?

12. Si mund t'i përgjigjemi një ateisti i cili pretendon që universi është i përjetshëm (nuk ka fillim)?

Përgjigjja: Sipas Ligjit të Dytë të Termodinamikës është e pamundur që universi të jetë i përjetshëm.

Ja një shembull për të thjeshtuar këtë ligj: nëse keni një filxhan me ujë të nxehtë në dhomë, nxehtësia transferohet nga uji i nxehtë në dhomë derisa temperatura e dhomës të jetë e barabartë me temperaturën e filxhanit. Ky është ligji i dytë i termodinamikës, ku energjia rrjedh nga nivelet e larta në nivele të ulëta me kalimin e kohës.

Që nga shfaqja e universit, ky ligj ndodh në çdo moment dhe në çdo gjë në univers, derisa temperatura e gjithçkaje në univers të bëhet e barabartë dhe kur kjo të ndodhë, do të ndodhë ajo që njihet si vdekja termike e universit.

Nëse universi do të ishte i përjetshëm, ai do të ishte pezulluar deri me tani - i vdekur termikisht. Megjithatë, universi tani është në një gjendje që është më pak se entropia maksimale dhe nuk ka arritur ende vdekjen termike. Prandaj, nuk është i përjetshëm, përkundrazi, ka një fillim të caktuar gjatë të cilit janë shfaqur koha dhe hapësira.

Është vërtetuar sipas të njëjtit ligj se universi filloi në një minimum entropie, që do të thotë se shfaqja e tij ishte pa një shembull precedent: ai u krijua nga asgjëja. Pra, ky ligj shkencor është në anën e kundërt me ateizmin.

13. Pse ligji i shkakësisë (shkak-efekt) nuk vlen edhe për Krijuesin? Ose, me fjalë të tjera, kush e krijoi Krijuesin?

Përgjigjja: Së pari, ligjet e qenieve të krijuara nuk vlejnë për Krijuesin; ky është një fakt i vetëkuptueshëm. Përndryshe, do të mund të thoshim edhe: “Kush e ka gatuar kuzhinierin?”

Kush e pikturoi piktorin?

Është e vetëkuptueshme se Krijuesi është Ai që solli në ekzistencë kohën dhe vendin. Pra, është e pakonceptueshme të thuhet se ligjet që Ai krijoi nga asgjëja duhet të vlejnë edhe për Të!

E dyta: Është e vërtetë se çdo qenie e krijuar duhet të ketë një krijues; megjithatë, në rastin e Krijuesit: **“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij.”** [Surja esh-Shūra: 11]

E treta: Krijuesi nuk është i krijuar, por është i përjetshëm. Pra, si mund të pyesim: Kush e krijoi Atë?

Krijuesi duhet të jetë i përjetshëm dhe i nevojshëm për të ekzistuar. Përndryshe, do të futeshim në problemin e “sekuencës së aktorëve” që çon medoemos në mosnëndodhjen e veprimeve. Pra, Krijuesi duhet të jetë medoemos ekzistues dhe i përjetshëm, i Lartësuar qoftë Ai!

14. Universi është shumë i madh. Si ka mundësi që ne, aq të vegjël, të jemi në qendër të këtij universi gjigant?

Përgjigjja: Ateisti bën një supozim të pakuptimtë, duke thënë: “Meqenëse universi është i madh, atëherë njeriu nuk është qendër e këtij universi!”

Ky supozim bazohet në premisën: “Meqenëse feramat janë të gjera dhe pronari i saj është shumë i vogël në krahasim me to, atëherë ai nuk është pronari i tyre!”

Në fakt, kjo nuk ka të bëjë fare me madhësinë.

Morali nuk ka përmasa materiale dhe është kriteri më i madh për t'i konsideruar njerëzit si më fisnikë ose më të përçmuar.

Ç'është e vërteta, njerëzit kanë rëndësi në bazë të moralit të tyre, prandaj çështja e madhësisë nuk është kriter!

Le të japim këtë shembull: nëse një mbret ka bërë disa ligje me të cilat e ka këshilluar djalin e tij dhe i ka këto ligje në një libër, a do të ishte e mundur që dikush të kundërshtonte dhe të thoshte: “Si ka mundësi që një mbret që zotëron miliona hektarë tokë të kujdeset për djalin e tij, madhësia dhe pesha e të cilit është edhe më e vogël sesa një pjesë e një milioni të tokës që zotëron ky mbret?”

Allahut i takon shembulli më i lartë.

Në radhë të parë, a mund të jetë i arsyeshëm një kundërshtim i tillë?

Kjo nuk ka të bëjë me peshë e me madhësi. Për më tepër, a nuk ishte krijuar ky univers nga një pikë që ishte bilionë herë më e vogël sesa maja e gjilpërës, ashtu siç theksojnë të gjithë fizikanët e botës?

Prandaj, madhësia është relative. Për më tepër, pse do të duhej të shqetësohej një ateist nga fakti se Allahu krijon çfarë të dojë dhe në mënyrën që Ai dëshiron?

A thua i mungojnë Zotit burimet që Ai të kursejë e të mos shpenzojë?

I Lartësuari është përtej këtyre gjërave!

Megjithatë, a është e vërtetë që ne përfaqësojmë vërtet një qendër në këtë univers?

Po, njeriu është qendra e këtij universi, sa i përket detyrës hyjnore.

Kjo detyrë hyjnore është feja.

Feja është besimi që mbart njeriu, që është sprova më e madhe nëpër të cilën i duhet të kalojë.

Juve ju kërkohet të jeni shërbëtor i Allahut të Plotfuqishëm, e në këtë rast ju jeni një qendër në këtë univers, jo për madhësinë, fuqinë ose aftësitë tuaja, por për shkak të detyrës hyjnore që e keni.

Ti je i aftë të bësh të mirën dhe të heqësh dorë nga e keqja, je i aftë të jesh besimtar ose jobesimtar.

Të gjithë e dimë se jemi të ngarkuar me detyra fetare, me dëshirë apo pa dëshirë!

Të gjithë e dinë, ateisti, besimtari, agnostiku dhe të gjithë të tjerët, se janë nën caktimin fetar. Secili prej tyre e percepton këtë detyrë hyjnore dhe e ka ndjesinë e një ndërgjegjeje morale. Secili e di se ka diçka brenda vetes që i thotë: “Bëje këtë dhe mos e bëj atë”, “Bëj mirë e mos bëj keq”. Secili prej nesh e di nga realiteti i vetvetes se i kërkohet të pajtohet me këto rregulla!

Ne jemi në qendër të këtij universi për nga detyra fetare.

Gjithashtu, ne jemi në qendër të këtij universi nga ana perceptuese dhe njohëse. Ne e perceptojmë, e kuptojmë dhe e njohim realitetin e ekzistencës sonë, realitetin e universit që na rrethon dhe kuptimin e ekzistencës sonë.

Ne jemi ata që jemi përgjegjës për detyrat, përgjegjësitë dhe për dhënie të llogarive.

Ne jemi të vetëdijshëm për paraqitjen e shkëlqyeshme të një formulimi të kujdesshëm. Ne jemi qenie të vetëdijshme për ligjet e përsosura dhe ne jemi në gjendje të kryejmë detyrat tona ose të refuzojmë ta bëjmë këtë. Ne jemi plotësisht të aftë për të zgjedhur dhe ne jemi të aftë të jemi besimtarë ose jobesimtarë.

Ne jemi në qendër të këtij universi. **“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie).”** [Surja El Ahzab: 72]

15. Disa ateistë thonë se ka kaq shumë planetë; kështu që, bazuar në teorinë e mundësive, do të ishte e saktë të supozohej se një nga këta planetë do të ishte i përshtatshëm për jetë... A do të mund të jetë ky konkluzion i vlefshëm?

Përgjigjja: Cila është lidhja midis ekzistencës së shumë planetëve dhe diskreditimit të përsosurisë si provë?

Me këtë rast, nuk bëhet fjalë për lëndë të para.

Të jesh në një pyll plot me të gjitha perimet, frutat dhe kafshët nuk do të thotë se, në mes të pyllit duhet të më shfaqet papritur një pjatë me ushqim të shijshëm e të gatuar. Pra, çështja nuk ka të bëjë me lëndët e para!

Po kështu, ekzistenca e rërës në shkretëtirat e botës nuk do të thotë që rreth meje në shkretëtirë mund të gjej procesorë digjitalë dhe çipa elektronikë që janë të përbërë prej rëre!

Çështja nuk është te lëndët e para; përkundrazi, është çështje e krijimit dhe përsosurie.

Ekzistenca e thjeshtë e një grupi planetësh nuk mjafton për të pasur mes tyre një planet që është krijuar në mënyrë të përsosur siç është Toka.

Ky është një rast i përsosurisë, krijimit dhe bërjes. **“E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë.”** [Surja en-Nemël: 88]

Prania e shumë planetëve të tjerë nuk justifikon aspak faktin që ka jetë në Tokë.

As e justifikon ekzistencën e kodit gjenetik brenda jush, i përbërë prej katër miliardë shkronjash e që kontrollon në mënyrë mbresëlënëse të gjitha funksionet, organet dhe hormonet tuaja, madje edhe para se të ekzistoni!

Jeta është informacion, jo materie.

Nëse unë dhe një ateist do të ngjiteshim në një planet dhe do të zbulonim një pajisje komplekse që funksionon me saktësi mbresëlënëse, edhe nëse ende nuk mund ta kuptojmë funksionin e saj, a do të mund të mohonim krijuesin e kësaj pajisjeje vetëm për shkak të madhësisë së madhe të planetit në të cilin jemi?

Intuita mendore më shtyn mua dhe ateistin që, kur e shohim këtë pajisje, të pranojmë ekzistencën e një Krijuesi të Aftë.

Ai që e mohon këtë intuitë logjike, që mohon ekzistencën e Krijuesit është në fakt ai të cilit i kërkohet të paraqesë dëshmitë, e jo ai që pohon ekzistencën e Tij!

Ateisti në këtë univers elegant është ai prej të cilit kërkohet të japë dëshmitë e asaj që thotë, jo besimtari!

Ateisti agnostik Carl Sagan dikur shkroi një roman të quajtur "Kontakti", në të cilin ai tregon se si shkencëtarët po kërkojnë inteligjencën jashtëtokësore.

Në këtë roman imagjinar, shkencëtarët zbuluan një seri të gjatë numrash të thjeshtë që vinin nga hapësira e jashtme. Meqenëse kjo sekuencë fillestare nënkupton një vlerë specifike matematikore, një vlerë që tregon një lloj saktësie, kjo ishte dëshmi e mjaftueshme mendore për të arritur në përfundimin se ky mesazh vinte nga një qytetërim tjetër që përpiquej të komunikonte me ne!

Ajo që është për të qeshur është se Carl Sagan është vetë një agnostik i famshëm, por mendja e tij e pranon faktin se kompleksiteti dhe organizimi i një mesazhi të vogël është provë e krijimit dhe përsosurisë!

Një seri e thjeshtë numrash do të vërtetonte patjetër praninë e një qytetërimi gjigant; kështu që si i përshkruani katër miliardë shkronjat brenda çdo qelize të trupit tuaj, nga të cilat, nëse një shkronjë do të mungonte, do të ndodhte një katastrofë?! Si ua atribuoni gjithë këtë përsosuri çudive të palogjikshme ateiste?

Nuk është e arsyeshme t'u drejtohemi çudive në mënyrë që të parandalojmë interpretimin e fenomenit në kuadrin e tij si indikacion i ekzistencës së Krijuesit.

“Thuaj: “Shikoni ç’ka në qiej dhe në Tokë!” Por shenjat dhe qortimet nuk u bëjnë kurrfarë dobie njerëzve që nuk besojnë.”

[Surja Junus: 101]

16. Pse nuk mund të ketë më shumë se një Krijues të pakrijuar?

Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: **“Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin.”** [Surja el-Enbija: 22]

Ekzistenca e një Zoti tjetër së bashku me Allahun përfshin shumëfishim, ndërsa shumëfishimi përfshin pamjaftueshmëri.

Pamjaftueshmëria e Krijuesit, - i Lartësuar qoftë mbi këtë, - e bën gjithësinë të pasigurt dhe të cenueshme, madje sjell prishjen e gjithësisë.

Nuk ka asnjë garanci që universi do të mbijetojë me një Zot të mangët!

“Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij!” [Surja el-Enbija: 22]

I Lartësuar është Krijuesi mbi pamjaftueshmërinë dhe nevojshmërinë. Ai është i Vetëmjaftueshëm, Mbajtës i çdo gjëje.

Duke i shtuar asaj që u përmend më lart, nëse do të kishte dy ose më shumë zota në qiej dhe Tokë, atëherë mundësia e konfliktit

do të ishte më e arsyeshme sesa të qenët në harmoni, sepse zota të shumtë do të nënkuptonin një mori vullnetesh, ndërsa shumësia e vullneteve do të shkaktonte pamjaftueshmëri të secilit prej tyre, gjë që do të sillte më pas prishjen e qiejve dhe të Tokës.

Dispozita natyrore e njeriut vërteton se Allahu është Një. Fizikan apo jo, me të parë këtë univers, njeriu e percepton që ka vetëm një Krijues, sepse kjo është një prirje e natyrshme njerëzore.

17. Pse feja?

Përgjigjja: Edhe ateisti më i vendosur do të besonte se të thuash të vërtetën është më mirë se të gënjeshtrosh, apo jo?

Ai do të besonte se ndershmëria është më e mirë se pandershmëria, apo jo?

Këta janë terma që nuk kanë lidhje me këtë botë dhe nuk ka asgjë në botën materiale që justifikon kuptimin ose domethënien e tyre.

Cili është kuptimi i së vërtetës?

Cili është kuptimi i ndershmërisë?

Nëse bëjmë një analizë të thellë të atomit, a do të zbulojmë disa kuptime sikurse e vërteta dhe gënjeshtroja?

Nëse vëzhgojmë formën fizike të galaktikave ose kiminë e hormoneve, a do të vëzhgojmë: ndershmëri apo pandershmëri - tradhti?

Terma të tillë nuk i përkasin kësaj bote materiale.

Megjithatë, ata janë terma realë dhe janë nga çështjet më domethënëse. Në fakt, vlera e një njeriu bazohet në moralin e tij, jo në madhësinë e tij fizike, numrin e atomeve ose nivelin e energjisë së qelizave të tij. Vlera e tij matet me përkushtimin e tij të brendshëm ndaj detyrave hyjnore.

Asgjë nga bota materiale nuk e ka këtë vlerë të përbashkët me njeriun.

Mund të ketë një njeri të mirë dhe një të keq, megjithatë nuk ka mal të mirë dhe të keq.

Ne nuk mund të zbulojmë një planet të ndershëm dhe një tjetër të pabesë. Vetëm njeriu merret me vlerat, qëllimin e jetës dhe me ekzistencën. Vetëm njerëzit dhe xhinët e kuptojnë (faktin) se ata janë nën detyrën fetare.

Perceptimi i kuptimit të moralit nuk është gjë tjetër veçse pjesë e ndjenjës sonë të brendshme instinktive të detyrës hyjnore.

Prandaj, feja është thelbësore që njeriu të kuptojë. Feja është e vetmja gjë që justifikon kuptimin e moralit, pse ekziston morali dhe pse ne ndiejmë nevojën t'i përmbahemi. Është e vetmja gjë që i jep moralit tiparin e tij dallues, sepse feja mund të kuptohet vetëm në parametrat e detyrës hyjnore. Vetëm nëpërmjet fesë mund ta dimë se morali është i natyrshëm për racën njerëzore.

Dhe nëpërmjet fesë, ne e njohim qëllimin e ekzistencës dhe e dimë se morali që e ndiejmë të nevojshme t'i përmbahemi, edhe nëse nuk e bëjmë këtë, është pjesë e detyrës hyjnore.

Pra, feja është një domosdoshmëri njerëzore.

Gjithashtu, përmes fesë ne e dimë pse jemi këtu e çfarë vjen pas vdekjes dhe e dimë kuptimin e ekzistencës. Dhe, (feja i përgjigjet pyetjes) çfarë kërkohet nga ne në këtë jetë?

Pra, feja është një domosdoshmëri për të ditur gjërat më të rëndësishme që e preokupojnë njeriun. Prandaj, pa fenë, gjithë bota do të kthehej në verbëri dhe në diçka të pavlerë.

Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Nuk ka rrugë drejt lumturisë dhe suksesit, as në këtë botë e as në botën tjetër, përveçse nëpërmjet të dërguarve. Nuk ka asnjë mënyrë për të njohur të mirën dhe të keqen në hollësi përveçse nëpërmjet tyre. As kënaqësia e Allahut nuk do të arrihet kurrë, përveçse nëpërmjet tyre.”⁶

Bota është e errët dhe e mallkuar, përveç asaj mbi të cilën ka lindur dielli i fesë dhe dielli i Mesazhit, siç thotë shejhul-islam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!).⁷

Pa fenë nuk mund të njihet qëllimi i ekzistencës e as kuptimi dhe vlera e së mirës. Pa mesazhet hyjnore, bota kthehet në një absurditet të frikshëm.

Kur feja të zhduket dhe njerëzit të mohojnë profecinë, njeriu do të kthehet në mbeturina të yjeve, siç thotë Carl Sagan, dhe në një insekt, siç thotë Sartri.⁸

⁶ Zad el-Mead (1/68).

⁷ Mexhmu'ul-fetava (19/93,94).

⁸ Video Source: The Shores of the Cosmic Ocean [Episode 1] Some part of our being knows this is where we came from. We long to return. And we can. Because the cosmos is also within us. We are made of star-stuff. We are a way for the cosmos to know itself. 06 min 04 sec. As for man turning into an insect, Sartre said this in his novel, Nausea.

Atëherë njeriu në fakt bëhet mbetje kimike, ose, më saktë, llum kimik, siç thotë Stephen Hawking.⁹

Profecia është puls i vetëm i ekzistencës dhe pa profecinë, shpikjet më të mrekullueshme dhe dëshirat më të këndshme kthehen në tmerr!

Pa fenë, bota me gjithë bukurinë e saj shndërrohet në një fantazmë të frikshme.

Nëse i bëni ndonjë ateisti ndonjë pyetje ekzistenciale, si: “Pse jemi në këtë botë ose çfarë vjen pas vdekjes?”, ai ose do ta shtrembërojë pyetjen tuaj, ose thjesht do të qëndrojë pa folur fare.

Prandaj, feja është një kriter i natyrshëm për të kuptuarit njerëzor dhe për të kuptuar domosdoshmërinë e vlerave morale. Gjithashtu, feja është thelbësore për njohjen e kuptimit e qëllimit të ekzistencës dhe për përmbushjen e robërisë ndaj Allahut, përmes së cilës arrihet shpëtimi.

⁹ From an interview with Ken Campbell on Reality on the Rocks: Beyond Our Ken, 1995.

18. Pse nuk është e mundshme që morali të jetë produkt i shpikur nga truri ose nga shoqëria?

Përgjigjja: Truri përbëhet saktësisht prej materialeve të njëjta sikurse bota materiale...!

Pavarësisht se sa i komplikuar është truri ose përbërjet materiale, rezultati i një shume të zerove nuk do të jetë gjë tjetër përveçse zero. Kështu, nëse materia nuk njeh as të mirën e as të keqen, atëherë e njëjta gjë vlen edhe për trurin.

Këtu pyesim ateistin: Si u shfaq koncepti i së mirës dhe së keqes kur gjithë bota materiale është moralisht neutrale, rrjedhimisht nuk njeh as të mirën e as të keqen?

Pyetja e dytë: Sipas trurit, çfarë e pengon shfarosjen e gjithë njerëzve në Tokë?

Çfarë e pengon vendosjen e racave (të paragjykuara si inferiore) në kafaze kafshësh?

Çfarë e pengon asgjësimin e të sëmurëve, të paaftëve, personave me aftësi të kufizuara dhe racave të paragjykuara si inferiore që t'u ndodhë sikurse ajo që ndodhi në projektin e seleksionimit natyror të kryer nga nazistët - Projekti Aksioni T4?¹⁰

¹⁰ https://en.wikipedia.org/wiki/Aktion_T4

Truri, në formën e tij materiale, nuk është në gjendje t'u përgjigjet pyetjeve të tilla duke i vlerësuar ato si të gabuara ose të drejta.

Truri është plotësisht neutral kur bëhet fjalë për moralin, pasi është i përbërë prej të njëjtave atome që i ka toka.

Në fakt, truri dhe morali nuk kanë asnjë lidhje.

Sa i përket idesë se shoqëria është themeluese e moralit, kjo do të ishte e çuditshme, pasi morali ka të bëjë me njeriun si njeri dhe jo me shoqërinë në tërësi.

Për më tepër, sikurse materiali, edhe shoqëria përbëhet prej elementeve të ndryshme dhe shumica e zerove përsëri do të prodhojë vetëm zero. Pra, si e shpiku shoqëria moralin, i cili në radhë të parë nuk i përket botës materiale?

Në këtë rast, nëse kjo do të ishte e saktë dhe ne e konsiderojmë moralin produkt të shoqërisë, atëherë nazistët do të kenë të drejtë në shfarosjen e të tjerëve, sepse shoqëria do ta besonte këtë gjë si diçka që është morale.

Kur bota vendosi të ndjekë penalisht nazistët, ky vendim u bazua në faktin se morali është diçka absolute dhe jo produkt i shoqërisë. Përndryshe, ata nuk do të kishin mundur t'i ndjekin penalisht nazistët dhe nuk do ta kishin kuptuar fare se ata kishin bërë gabim.

Në fakt, morali është i pavarur nga shoqëria, e drejta është e drejtë edhe në shoqëritë e mira edhe në ato të këqija. Po kështu, gabimi është gabim si në shoqëritë e mira ashtu edhe në ato të këqija.

Morali ka një kuptim që shtrihet përtej trurit dhe komunitetit.

19. Ekziston më shumë se një Zot në kulturat e ndryshme të Botës, kështu që pse ta besojmë posaçërisht Allahun?

Nuk ka Zot të adhuruar në të gjitha fetë në Tokë përveç Allahut.

Mosmarrëveshja jonë me të gjitha fetë e botës është se ata kanë adhuruar zota të tjerë përpos Allahut, sikurse Jezusin dhe Shpirtin e Shenjtë në krishterim, e Vishnu, Shiva dhe Brahma në hinduizëm... etj.

Të gjitha fetë besojnë në Allahun, Zotin Një e të Vetëm, dhe e konsiderojnë Atë si Krijuesin e ekzistencës.

Por, ata thjesht adhurojnë edhe zota të tjerë përpos Allahut.

Edhe idhujt e politeistëve nuk adhuroheshin si zota për veten e tyre, sepse ata e pranuan se Allahu është Krijuesi, por i besojnë ata idhuj si ndërmjetës tek Allahu. **“Nëse ti (Muhamed) i pyet ata se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush i ka nënshtruar (të rrotullohen) Diellin e Hënën, - me siguri që ata do të të thonë “Allahu!” Atëherë, si po largohen (nga rruga e drejtë)?”**
[Surja el-Ankebut: 61]

Shejhul-islam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Kushdo që mendon se adhuresit e idhujve besuan se idhujt e krijojnë botën ose se ata lëshojnë shi, rritin bimë ose krijojnë kafshë ose ndryshe, ai është injorant lidhur me ta. Përkundrazi, ata i adhuruan këta idhuj për të njëjtën arsye që politeistët i adhuruan varret.”¹¹

Uill Durant thotë se origjina e hinduizmit pagan në fund të fundit kthehet në besimin në Zotin Një. Ai thotë për perënditë hindu: “Këto mijëra perëndi përfaqësojnë të njëjtin model të kishave të krishtera që mbajnë mijëra figura si shenjtorë. Një hindu nuk mendon kurrë, qoftë dhe për një moment të vetëm, se perëndi të tilla të panumërta kanë sovranitetin suprem.”¹²

Një raport i dorëzuar qeverisë britanike në Indi gjatë pushtimit britanik të Indisë thoshte: “Përfundimi i përgjithshëm i komitetit, i arritur nga hulumtimi, është se shumica dërrmuese e indianëve kanë besim të fortë në një Zot Suprem.”¹³

Allahu është Një në të gjitha fetë e tokës. **“Zoti ynë dhe Zoti juaj është Një.”** [Surja el-Ankabūt: 46]

Idolët dhe zotat e njerëzve nuk janë tjetër pos ndërmjetësues tek Allahu, gjë që është herezi (mosbesim). **“Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë. Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë,**

¹¹ Mexhmu’ul-fetava, vëllimi 1, fq. 359.

¹² The Story of Civilization, Will Durant, vol.3, p. 209.

¹³ Ibid.

përveç Tij, duke thënë: “Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu.” [Surja ez-Zumer: 3]

20. Nëse një person bën diçka për të cilën nuk ka nevojë, kjo është absurde! Zoti nuk ka nevojë për ne, pra pse na krijoi?

Përgjigjja: Është marrëzi të mendosh se nevoja përputhet me absurditetin! Në fakt, nevoja përputhet me mençurinë, jo me absurditetin.

Një mjek i pasur dhe me reputacion mund t'i trajtojë njerëzit pa pasur nevojë asgjë prej tyre, por i trajton ata për përfitimin e tyre. Këtu nuk e cilësojmë si absurd veprimin e tij!

Mençuria dhe një qëllim i madh pas aktit nuk sillen rreth ciklit të nevojës - absurditetit! Për më tepër, një notues mund të shpëtojë një fëmijë nga mëshira, pastaj ta lërë atë dhe të shkojë pa pritur që prindërit e fëmijës ta falënderojnë. Këtu, veprimi i tij nuk klasifikohet si nevojë ose absurditet, përkundrazi, ky është një veprim bujar, me qëllim fisnik dhe person me karakter të mirë!

Pra, nevoja dhe absurditeti nuk janë medoemos të ndërlidhura.¹⁴

¹⁴ Dhahiratu nakdi ed-din fil-felsefeti el-haditheh, dr. Sultan el-Umejri (temë doktorate).

Sipas librit “Sahih Muslim”, Allahu i Plotfuqishëm në një *hadith kudsij* ka thënë: “O robërit e Mi, edhe po qe se të gjithë ju, i pari e i fundit, përfshirë njerëzit e xhinët, bëheni si njeriu më zemërmirë prej jush, kjo gjë aspak nuk do ta shtonte sundimin Tim. O robërit e Mi, edhe nëse të gjithë njerëzit e xhinët, fillim e mbarim, bëheni si njeriu më zemërprishur nga mesi juaj, kjo gjë as që do të pakonte sundimin Tim. O robërit e Mi, në qoftë se të gjithë njerëzit e xhinët, fund e krye, tubohen në një vend, më drejtohen me kërkesa e Unë ia jap gjithsecilit atë që kërkon, kjo nuk do të pakësonte asgjë nga ajo që gjendet tek Unë, respektivisht aq sa përthith gjilpëra kur futet në det. O robërit e Mi! Vërtet ato janë veprat tuaja, të cilat i ruaj e më pas jua shpërblej, kështu që, kushdo që gjen mirë, le ta falënderojë Allahun, ndërkaq, ai që gjen keq, le ta qortojë vetëm vetveten.”¹⁵

Allahu është i lirë nga nevoja e botëve. Prandaj, përpjekja dhe puna jonë janë vetëm për ne. **“Kush përpiqet, përpiqet vetëm për të mirën e vetvetes, se Allahu, në të vërtetë nuk ka nevojë për asgjë.”** [Surja el-Ankabūt: 6]

Ne e dimë se Allahu ka urtësi në të gjithë krijimin e Tij, edhe nëse ne jemi të paditur për të dhe se injoranca e pacientit për urtësinë e mjekut nuk do të thotë se vendimet e mjekut janë absurde.

¹⁵ Sahih Muslim, hadithi 2577.

Njohja e urtësisë hyjnore nuk kërkon kuptimin e të gjitha dimensioneve të urtësisë, por mjafton të kuptosh disa prej tyre!

Është e mjaftueshme që ne të dimë se jemi të ngarkuar me adhurimin e Allahut dhe të dimë se ekziston një urtësi hyjnore. Kjo është e mjaftueshme për ne në përgjithësi; përndryshe, ne do të ishim si ata që mohojnë gjithçka që nuk e kuptojnë. **“Por ata e mohojnë atë që nuk e njohin plotësisht, ndërkohë që nuk u ka ardhur ende përmbushja e (premtimeve të) tij. Kështu kanë mohuar edhe popujt që ishin para tyre; prandaj shiko si kanë përfunduar keqbërësit!”** [Surja Junus: 39]

Allahu është i Urtë dhe na krijoi për një qëllim të urtë, i Lartësuar qoftë Ai! Vetëm Ai është me të vërtetë i denjë për adhurim, askush tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut, Krijuesi që na solli në ekzistencë nga hiçi. Ai ka thënë: **“O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat).”** [Surja el-Bekare: 21]

Është Ai që na udhëzoi, Ai që na dha ligjet, na urdhëroi dhe na ndaloi. **“Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi.”** [Surja El-Araf: 54]

Nuk është vetëm krijimi që i përket Allahut, por edhe urdhri i takon Atij. Ne u bindemi urdhrave të Tij; lavdia i qoftë Atij!

Adhurimi është e drejta e Allahut ndaj robërve të Tij. Ai, i Plotfuqishmi, na krijoi, na dha jetë, na dha furnizim, na udhëzoi

dhe na dërgoi të dërguarit e Tij për të na sprovuar se cili prej nesh është më i miri në vepra. Pra, adhurimi është e drejtë e Allahut ndaj nesh. **“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”** [Surja el-Mulk: 2]

Jeta jonë e kësaj bote dhe e botës tjetër do të rregullohet vetëm me adhurim, as morali ynë nuk përmirësohet pa të; sepse adhurimi parandalon imoralitetin dhe keqbërjen dhe me të do të përmirësohet jeta e kësaj bote. Zoti ynë i Madhërishëm ka thënë: **“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.”** [Surja el-Ankabūt: 45]

Parajsën do ta arrijmë vetëm me adhurim, sepse ky është shpëtimi në botën tjetër dhe po ashtu është edhe begati në këtë botë.

Adhurimi është për ne dhe për të mirën tonë dhe është obligim që e kemi ndaj Allahut të Madhëruar, sepse Ai është Krijuesi ynë. Dobia e adhurimit na kthehet vetëm neve dhe neglizhenca na prek vetëm ne.

Xheneti është i shtrenjtë, andaj, kush e dëshiron Xhenetin, le të punojë për të. Ne kemi nevojë për Allahun e Plotfuqishëm... Ne kemi nevojë ta adhurojmë Atë, ndërsa Ai është i lirë nga nevoja për ne dhe për të gjitha krijesat e Tij.

21. Si ta njohim Allahun?

Përgjigjja: Ne e njohim Allahun në shumë mënyra, prej të cilave këtu do të përmendim vetëm katër prej tyre:

Mënyra e parë: Ne e njohim Allahun përmes prirjes së shëndoshë natyrore. Njeriu është i prirë të dijë se ka një krijues. Në mënyrë të natyrshme, ju e dini që ka një krijues që ju ka krijuar ju në këtë formë, me një përsosuri të mahnitshme.

Gjithashtu, njeriu sipas natyrës së tij e di se nga ai kërkohet që t'i drejtohet Krijuesit të tij përmes adhurimit dhe, gjithashtu, e di se ai ka nevojë për Krijuesin e tij të lavdishëm në çdo kohë, dhe kjo ndjenjë nevojë për Allahun është edhe më e madhe në fatkeqësi.

Për nga natyra, gjithë njerëzimi është i prirë ta njohë Allahun.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”** [Surja er-Rrum: 30]

Ai, po ashtu, ka thënë: **“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je.” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Këtë nuk e kishim ditur.”** [Surja El-Araf: 172]

Para se të krijoheshim, ne ishim të prirë natyrshëm ta njihnim Allahun dhe të ishim robër të Tij: **“... dhe Ai i bëri të dëshmojnë për veten e tyre [duke pyetur]: “A nuk jam unë Zoti juaj?” Ata thanë: “Po; me të vërtetë, ne dëshmojmë.”**

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) më tej në një hadith, vërtetësinë e të cilit e pranojnë Buhariu dhe Muslimi, ka thënë: "Çdo fëmijë lind me një prirje të shëndoshë natyrore."¹⁶

Ne të gjithë kemi lindur në atë prirje natyrore, e cila është e mjaftueshme për çdo person që kërkon të vërtetën për ta udhëhequr atë dhe që ai duhet t'i nënshtrohet asaj të vërtete pasi ta gjejë atë.

Këtë prirje nuk mund ta mohojnë as njerëzit më të vendosur në mosbesim, sidomos në kohë të vështira. Në fakt, të gjithë njerëzit i drejtohen Allahut kur janë në vështirësi dhe në kohë të tillë harrojnë gjithçka që i shoqërojnë Atij në adhurim. **“Kur ju godet fatkeqësia në det, ata që ju i adhuronit në vend të Atij, zhduken. Por, pasi Ai ju shpëton në tokë, ju i ktheni shpinën. Njeriu është mosmirënjohës.”** [Surja el-Isrā: 67]

Kur një person është në ankth të rëndë dhe mendon se shkatërrimi është i afërt, ai nuk i lutet askujt tjetër përveç Allahut dhe harron të gjitha besimet e tij politeiste. Kjo thirrje e sinqertë

¹⁶ Sahīh Muslim, hadithi 2658.

për të gjithë ata që janë në fatkeqësi nxitet nga prirja e shëndoshë natyrore që çdo person ka brenda tij.

Eisenhouer, - një nga presidentët amerikanë, - i cili ishte komandant i forcave amerikane në Luftën e Dytë Botërore, pasi dëshmoi se si ushtarët kthehen në gjendjen e tyre natyrore në kohën e një rreziku të madh, tha: “Nuk ka ateistë në hendeqe.”¹⁷

Në hendeqe gjatë luftës nuk ka njeri që e mohon Allahun, të gjithë kthehen tek Ai. Kjo është prirja e vërtetë natyrore që e pranon gjithë njerëzimi në kohë fatkeqësie.

Mënyra e dytë për ta njohur Allahun është arsyeja: Ne e njohim Allahun përmes arsyes.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!”** [Surja et-Tur: 35]

Sipas arsyes, ka tri mundësi, që nuk kanë të katërtën:

Mundësia e parë: Jemi krijuar pa Krijues: **“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi”**, që është e pamundur, sepse si mund të jemi krijuar pa Krijues?

Mundësia e dytë: Ne e krijuam veten **“... apo mos janë ata krijues të vetvetes”**, e cila gjithashtu është e pamundur, sepse si mund ta krijoj veten time para se të jem krijuar?

¹⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/There_are_no_atheists_in_foxholes

Pastaj, sipas arsyes, mbetet mundësia e tretë, të cilën as që e ka përmendur vargu fisnik pasi është e vetëkuptueshme. Kjo është se ne kemi një krijues që na ka krijuar.

Pra, ne e njohim Allahun përmes arsyes.

Mënyra e tretë për ta njohur Allahun është të reflektosh mbi krijimin e Tij:

Meditimi për krijimin e Allahut na vë përpara madhësisë së Allahut të Lartësuar. **“Thuaj: “Shikoni ç’ka në qiej dhe në Tokë!”**
[Surja Junus: 101]

Sa më shumë që mendojmë për krijimin e përpiktë të Allahut dhe përsosurinë e mahnitshme, aq më shumë rritet njohuria jonë për Të.

Kjo është ajo që kemi përmendur më parë në kontekstin e sjelljes së dëshmisë dhe provës së providencës dhe përsosurisë.

Mënyra e katërt për ta njohur Allahun është nëpërmjet të dërguarve:

Kjo është mënyra më e mirë përmes së cilës e njohim Allahun e Lartësuar. Kjo është ta njohësh Atë nëpërmjet të dërguarve dhe profetëve të Tij.

Të dërguarit na treguan për Allahun, cilësitë dhe esencën e Tij. Nëpërmjet profetëve ne e njohim Allahun me emrat dhe cilësitë e Tij, dimë si ta adhurojmë e t'i afrohem Atij dhe si të shpëtojmë nga dënimi i Tij në Ditën e Llogarisë. Të dërguarit i thërrisnin

njerëzit që të adhuronin Allahun, ose, me fjalë të tjera, ata i thërrisnin ata që të kthehen në gjendjen e tyre natyrore në të cilën janë krijuar dhe ta adhurojnë Allahun ashtu siç ka urdhëruar Ai.

Të dërguarit i udhëzuan njerëzit në rrugën e së vërtetës dhe shpëtimit: **“(Këta janë) të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve. Se, Allahu, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm.”** [Surja en-Nisa: 165]

Kështu, profetët dhe të dërguarit na informuan për Allahun, ndërsa përkrahja e Allahut iu dha atyre me anë të mrekullive të cilat nuk lënë askënd me arsyetim tek Allahu në Ditën e Kiametit.

Kjo është për shkak se Allahu i Lartësuar ju dha juve një prirje natyrore me të cilën mund të njihni Krijuesin tuaj. Ju dha arsyen, ju dha shikimin, në mënyrë që të mendoni për krijimin e Tij dhe dërgoi te ju të dërguar. Pra, nuk ka asnjë arsyetim për ju para Allahut.

22-Ekzistojnë aq shumë religjione, kështu që pse të zgjedhim Islamin?

Përgjigjja: Islami nuk është thjesht një religjion midis religjioneve të tjera.

Megjithatë, Islami pajtohet me besimin e gjithë profetëve të Dhiatës së Vjetër. Islami është një korrigjim i rrugës së feve që kanë devijuar dhe një rivendosje e besimit monoteist të profetëve të Dhiatës së Vjetër.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Ai ka urdhëruar për ju atë fe, të cilën ta zbuloi ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, duke thënë: “Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!” Por për idhujtarët është e rëndë ajo, në të cilën po i fton ti. Allahu zgjedh për këtë fe kë të dojë dhe udhëzon drejt saj këdo që kthehet tek Ai me pendim.”** [Surja esh-Shura: 13]

Në fakt, Islami nuk është një fe si çdo fe tjetër; përkundrazi, është origjina e të gjitha feve.

23. Çfarë është Islami?

Përgjigjja: Islami është nënshtrim, dorëzim dhe bindje ndaj Allahut të Madhëruar.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?!”** [Surja en-Nisa: 125]

T'i nënshtrohesh Allahut do të thotë t'i dorëzohesh plotësisht Atij dhe t'i bindesh me përkushtim, i Lartësuar qoftë Ai! Këta janë njerëzit më të mirë në aspektin fetar.

Allahu gjithashtu ka thënë: **“Zoti juaj është një Zot i vetëm, prandaj vetëm Atij përuljuni. Dhe jepu lajme të mira atyre që janë të përulur.”** [Surja el-Haxh: 34]

T'i nënshtrohesh vetëm Atij do të thotë t'i nënshtrohesh gjykimit të Tij.

Këto ajete tregojnë se Islami do të thotë nënshtrim absolut ndaj Allahut të Madhëruar, dorëzim ndaj Tij dhe pajtueshmëri me legjislacionin dhe metodologjinë e Tij me pëlqim e pranim. Ky është thelbi dhe realiteti i Islamit. Është t'i nënshtrohesh Allahut në gjykimin dhe legjislacionin e Tij.

Islami është feja e Allahut për të gjithë njerëzimin. Allahu ka thënë: **“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.”** [Surja Al-Imran: 19]

Nga të gjitha religjionet, Islami është e vetmja fe të cilën Allahu e pranon. **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”** [Surja Al-Imran: 85]

Islami është feja për të cilën Allahu i dërgoi të gjithë profetët dhe të dërguarit për ta predikuar. Feja e të gjithë profetëve është e njëjtë, përkatësisht Islami. Të gjithë ata kanë thirrur në monoteizëm (njëshmëri e Allahut), megjithëse ligjet e tyre ishin të ndryshme.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: “S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!”** [Surja el-Enbija: 25]

Islami është feja e vetme që ka ruajtur monoteizmin.

Është e vetmja fe e vërtetë monoteiste në tokë tani, kurse të gjithë pasuesit e ligjeve të tjera kanë pasur një pjesë të politeizmit, qofshin pak, qofshin më shumë. Pas vdekjes së profetëve që i lanë njerëzit në besimin monoteist, njerëzit eventualisht adoptuan politeizmin dhe sot, përveç Islamit, asnjë fe tjetër nuk e ruan monoteizmin e pastër me të cilin erdhën profetët.

24. A mund t'u përgjigjet Islami pyetjeve në të cilat mendjet njerëzore nuk kanë arritur të gjejnë përgjigje, si: Nga erdhëm ne? Pse jemi këtu në këtë botë? Ku është destinacioni ynë përfundimtar?

Përgjigjja: Islami u është përgjigjur të gjitha këtyre pyetjeve në një ajet të Kuranit fisnik, ku Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?!”** [Surja Jasin: 22]

Nga ke ardhur ti? Allahu më krijoi mua: **“... i Cili më ka krijuar...”**

Ku do të shkoj pas vdekjes? Te Zoti im që të më llogariten veprat e mia: **“... e tek i Cili do të ktheheni të gjithë.”**

Pse keni ardhur në këtë botë? Për të adhuroar Allahun dhe për t'u sprovuar.

Pse duhet ta adhuroj Allahun? Është e natyrshme që unë të adhuroj Allahun që më krijoi, sepse kjo është natyra e raportit ndërmjet robit dhe Zotit të tij: që robi të adhurojë Zotin dhe Krijuesin e tij. **“Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar?”**

Është një varg i vetëm që kombinon përgjigjen në të tri pyetjet më domethënëse të cilat njerëzimit i duken hutuese: **“Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?!”** [Surja Jasin: 22]

25. Si e dini se Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është i dërguar i Allahut?

Përgjigjja: Numri i madh i mrekullive nënkupton dëshmi të vazhdueshme logjike dhe siguri të plotë.

Në fakt, Aristoteli ishte filozof në të gjitha veprat e tij, jo vetëm në një fjali që ai ka thënë ose një analizë filozofike që ai ka bërë. Po ashtu, Hipokrati ishte mjek për shkak të të gjitha projekteve të tij mjekësore, jo vetëm për shkak të një operacioni që ai kreu.

Në mënyrë të ngjashme, sasia e mrekullive të transmetuara nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ofron dëshmi logjike të vazhdueshme dhe një siguri të plotë se ai është profet.

Nëse meditoni mbi biografinë e tij, do ta gjeni atë të besueshëm, pasi ai ishte i njohur si i sinqertë dhe këtë e kishin pranuar edhe njerëzit më armiqësorë ndaj tij, prandaj nuk ishte akuzuar asnjëherë për ndonjë gënjeshtëri ose imoralitet. Ai, po ashtu, na kishte njoftuar për ngjarje të papara që ndodhin pikërisht ashtu siç ka parathënë dhe, mbi të gjitha, besimi i tij në të cilin ai i ka thirrur njerëzit që nga dita e parë ishte në përputhje me besimin e të gjithë profetëve. Pastaj, është ai që i gëzonte profetët për ardhjen e tij qindra vjet para se të vinte. E gjithë kjo nënkupton dëshmi logjike të vazhdueshme dhe siguri të plotë të vlefshmërisë së Mesazhit të tij.

Atëherë, çfarë të themi për mrekullinë më të madhe që ai solli, Kuranin fisnik?

Kurani, me anë të të cilit Allahu i sfidoi njerëzit e retorikës për të dalë me diçka të ngjashëm me të, ose edhe të ngjashme me një nga kaptinat e tij. Por, çfarë bënë ata?

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Nëse nuk mundeni, dhe kursesi nuk do të mundeni...”** [Surja el-Bekare: 24]

Ata as e bënë, as mund ta bënin këtë.

Sfida e Kuranit fisnik ende vlen për njerëzit e retorikës nga politeistët e njerëzit e elokuencës dhe, përkundër kësaj, ata janë të paaftë për ta mposhtur sfidën dhe nuk kanë arritur të sjellin diçka të ngjashme me të.

Dr. Abdullah Dirazi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "A nuk u frikësua i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) se kjo sfidë do të nxiste entuziazmin e tyre letrar?"

Pra, ata do të ngriheshin për ta konkurruar, pasi të gjithë janë në gatishmëri të lartë; dhe çfarë do të bënte nëse një grup retorikësh do të angazhoheshin për të prodhuar një fjalë që do të ishte në të njëjtin nivel, qoftë dhe në disa aspekte!

Pastaj, nëse ai do ta bindte vetveten që t'ua linte këtë rregull njerëzve të kohës së tij, si do t'ua linte atë brezave të ardhshëm?

Në të vërtetë, kjo është një aventurë që një njeri që ia di hallin vetes nuk do të guxonte ta bënte, përveç nëse ai në të vërtetë

ka besim të plotë në mënyrën se si dekreti hyjnor i trajton çështjet dhe në informacionin që merr nga qielli. Prandaj, ai e la këtë sfidë për të gjithë botën, e që ishte një veprim i vendosur; pasi të gjithë ata që u përpoqën ta imitonin treguan paaftësi totale dhe pësuan dështim flagrant përgjatë gjithë epokave dhe kohërave.”¹⁸

Këta politeistë besuan se grumbullimi i ushtrive dhe formimi i grupeve për të luftuar kundër të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte më e lehtë sesa imitimi i Kuranit dhe pranimi i sfidës. Kjo ishte gjëja e fundit që donin të bënin. **“Jobesimtarët thonë: “Mos e dëgjoni këtë Kuran! Flisni e qeshni me zë të lartë, që të ndërprisni leximin e tij!”** [Surja Fussilet: 26]

As të gjithë arabët, as kombet e tjera, të cilave iu përcoll sfida, nuk dolën me diçka në lidhje me këtë sfidë, diçka që do të mund të ngushëllonte ateistët ose diçka me të cilin ata mund të ngushëllonin të tjerët.

El Alusi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: “Asnjëri prej tyre nuk ka thënë asnjë fjalë deri më sot, ose nuk ka përmendur një përshkrim ose diçka të përshkruar.”

Xhubejr ibn Mutimi, i cili në atë kohë nuk ishte ende musliman, tha: “E kam dëgjuar Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut

¹⁸ En-Nebeul-adhim, dr. Abdullah Diraz, fq. 44-45.

qofshin mbi të!) duke lexuar suren Tur në namazin e akshamit, kur arriti në këtë ajet: **“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?! A mos vallë ata kanë krijuar qiejt dhe Tokën?! Nuk është kështu, por ata nuk janë aspak të bindur. A mos zotërojnë thesaret e Zotit tënd?! Apo mos janë ata sunduesit (e gjithçkaje)?!”** [Surja et-Tur: 35-37]

Ai tha: “Zemra ime pothuajse fluturonte.”¹⁹

Kurani ka sekrete të mahnitshme që mund të arrijnë në shpirtin e njeriut.

Thjesht reflektoni se si gratë politeiste u grumbulluan rreth shtëpisë së Ebu Bekrit kur ai recitonte Kuranin, sepse ishin tepër të mahnitura prej tij, aq sa burrat kurejshë i kapi paniku për shkak të kësaj.²⁰

Prandaj, delegacionet arabe ranë dakord që të mos dëgjonin Kuranin dhe të mos lejonin familjet e tyre ta dëgjonin atë, pasi kjo ishte mënyra e vetme për të mbajtur mosbesimin e tyre.

Nga mrekullitë e pashtershme të Kuranit fisnik është edhe ajo që përmendi dr. Abdullah Dirazi (Allahu e mëshiroftë!) në lidhje me zbritjen e ajeteve të Kuranit në kohë të ndryshme, pastaj Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) vë në dukje se si disa vargje vendosen në vende të veçanta në kapituj, ndërsa

¹⁹ Sahih el-Buhari (4854).

²⁰ Sahih el-Buhari (3905).

vargjet e tjera vendosen në të tjera, pastaj në fund, çdo kapitull shfaqet si një strukturë e pavarur. Ai (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Në kohën e shpalljes së Kuranit, disa tema në Kuran po ndaheshin gjithnjë e më shumë nga temat e tjera dhe gradualisht po formonin njësi të pavarura pasi u shpallën ajete të tjera pas tyre. Disa prej tyre u shtuan në një kapitull dhe të tjerët u mbivendosën në një kapitull tjetër, sipas urdhrit të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!), të cilin ai e mori nga Shpirti i Shenjtë (Xhibrili).

Nëse marrim parasysh datat e panumërta - datat e zbritjes së ajeteve të Kuranit fisnik dhe vëmë re se kjo shpallje në përgjithësi lidhej me rrethana dhe raste të veçanta, kjo na shtyn të pyesim për kohën kur u zhvillua procesi i organizimit të secilit kapitull në një njësi të pavarur.

Duket sikur Kurani të ishte pjesë e veçantë dhe e numëruar e një ndërtese të lashtë, e cila synohej të rindërtohej diku tjetër në të njëjtën formë si më parë; përndryshe, si mund të shpjegohet ky rregullim i menjëhershëm dhe sistematik në të njëjtën kohë në lidhje me shumë kapituj?

Sidoqoftë, çfarë garancie historike mund të marrë një person kur zhvillon një plan të tillë në lidhje me ngjarjet e ardhshme, kërkesat e tyre legjislative dhe zgjidhjet e dëshiruara për to, për të mos përmendur formën gjuhësore në të cilën duhet të paraqiten këto zgjidhje dhe përputhshmërinë e tyre stilistike me kapitujt specifikë?

A nuk arrijmë në përfundimin se përfundimi i këtij plani dhe realizimi i tij në formën e dëshiruar kërkon ndërhyrjen e një Krijuesi të Madh, i Cili ka aftësinë për të vendosur këtë koordinim të dëshiruar?

A nuk do të arrijmë në përfundimin se kompletimi i këtij plani dhe realizimi i tij në formën e dëshiruar kërkon ndërhyrjen e një Krijuesi të Madh, i Cili ka aftësinë për të vendosur këtë koordinim të dëshiruar?²¹

Në fakt, Kurani është një mrekulli e pavarur që dëshmon vërtetësinë e profecisë së Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Mrekullitë e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që ndodhën nga duart e tij janë të shumta, duke kaluar mbi një mijë të tilla. Ato kanë ndodhur jo shumë moti dhe njerëzit që i kanë transmetuar ato janë më besnikët dhe më të drejtët.

Ata që na i transmetuan këto mrekulli nuk kishin gënjyer kurrë as në çështjet më të vogla, e lëre më të gënjejnë për Pejgamberin, kur e dinin se kushdo që gënjen kundër tij me qëllim, do të zinte një vend në Zjarr, ashtu siç kishte paralajmëruar ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Për disa nga mrekullitë e Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) mijëra sahabë ishin dëshmitarë dhe dhjetëra

²¹ Medhal ilel-Kuran el-Kerim, dr. Abdullah Diraz.

prej tyre i kishin raportuar ato, kështu që si mund të bashkëpunonin ata për të gënjyer për të gjitha këto?!

Shembull i mrekullive të tij që u dëshmuar nga një mori njerëzish është hadithi i rënkimit të trungut të pemës, i cili është një hadith i mirënjohur *mutevatir*. Ky hadith thotë se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) po mbante një predikim duke qëndruar në një trung peme. Kur iu bë një foltore, ai u ngjit në të dhe mbajti predikimin, ndërsa trungu i pemës rënkonte si një fëmijë i vogël. Trungu vazhdoi të rënkonte derisa Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e përqafoi, kështu që u qetësua dhe pushoi së rënkuari.

Ky hadith është transmetuar nga një grup sahabësh: Enes ibn Maliku, Xhabir ibn Abdullahu, Abdullah ibn Abasi, Abdullah ibn Omeri, Ubej ibn Kabi, Ebu Seidi, Sehl ibn Seidi, Aishe bint Ebu Bekri dhe Umu Seleme.

A do të gënjenin kolektivisht një numër aq i madh sahabësh për të transmetuar një ngjarje sikurse kjo?

Në të vërtetë, disa nga mrekullitë e tij u dëshmuar nga mijëra sahabë, siç ndodhi kur uji rridhte nga gishtat e tij fisnikë, derisa një mijë e pesëqind sahabë morën abdes dhe pinë prej tij, siç transmetohet në një hadith *mutevatir* nga Buhariu dhe Muslimi.

Një ngjarje tjetër ishte kur ai e rriti sasinë e vogël të ushqimit për të ushqyer ushtrinë e tij të madhe, gjë që është raportuar edhe në transmetime të shumta të sahabëve. Vetëm Buhariu ka

përmendur mrekullinë e shtimit të ushqimit nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në pesë vende në librin e tij Sahih.²²

Kur argumentet e së vërtetës janë të vendosura dhe mrekullitë që vërtetojnë profecinë e tij janë të shumta (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), atëherë si mund t'i mohojë një person i arsyeshëm të gjitha këto?

Ja dhe disa shembuj të tjerë të mrekullive të tij:

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) u tha muslimanëve gjatë një nate se do të frynte një erë e fortë dhe i ndaloi njerëzit të ngriheshin në këmbë. Megjithatë, një burrë u ngrit në këmbë dhe pastaj ai u mbart nga era që e hodhi në një vend të largët.²³

Ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) gjithashtu i njoftoi ata për vdekjen e Nexhashiut në të njëjtën ditë që ai vdiq. Ai fali namazin e xhenazes për të, pasi bëri tekbir katër herë.²⁴

Për më tepër, Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) tregoi për martirizimin e Omerit, Othmanit, Aliut, Talhait dhe

²² El-Buhari (1217, 2618, 3578, 4101, 6452). Këto të gjitha janë ngjarje të ndryshme të cilat i ka përmendur Buhariu.

²³ Sahih Muslim (3319).

²⁴ Sahih el-Buhari (1333).

Zubejrit (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) dhe tregoi se ata nuk do të vdisnin në shtretërit e tyre si njerëzit e tjerë.

Një ditë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) u ngjit në mal së bashku me Ebu Bekrin, Omerin, Othmanin, Aliun, Talhain dhe Zubejrin. Një gur i madh filloi të dridhej, kështu që i Dërguari i Allahu (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i tha malit: "Qetësohu, se nuk ka tjetër njeri mbi ty përveçse një Pejgamberi, një pohuesi të së vërtetës e shehidë."²⁵

Ai vërtetoi se ishte profet, se Ebu Bekri ishte pohues i së vërtetës dhe se të tjerët do të ishin dëshmorë. Gjithçka për të cilën ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) pohoi, ndodhi në të vërtetë.

Për më tepër, ka 150 hadithe ku Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) iu lut Zotit të tij dhe iu përgjigj menjëherë, ndërsa njerëzit ishin dëshmitarë!²⁶

Dhe, kur banorët e Mekës i kërkuan të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) që t'u tregonte një mrekulli, ai u tregoi Hënën të ndarë në dy gjysma, derisa ata panë malin Hira mes tyre. Ky hadith është mutevatir, që do të thotë se është i shkallës më të lartë të autenticitetit.

²⁵ Sahih Muslim (2417).

²⁶ Këto hadithe janë mbledhur nga Seid bin Abdul-Kadir Bashanfar në librin e tij Dala'il el-Nubuveh.

Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) lexonte suren el-Kamer, e cila përmban mrekullinë e çarjes së Hënës, në tubime të mëdha si: të premtën dhe për Bajrame, në mënyrë që njerëzit të mund të dëgjonin çfarë përmbante nga mrekullitë e tij kjo sure dhe ai (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) e përdori atë si dëshmi të së vërtetës së profecisë së tij.

Gjithashtu, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) informoi se Ademi ishte krijesa e fundit e gjallë: **"Dhe, Ai e krijoi Ademin, krijesën e fundit, pas kohës së ikindisë (pasdite) të xhumasë."**²⁷

Ky fakt shkencor tashmë është vërtetuar, kështu që si e dinte Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) se Ademi (paqja qoftë mbi të!) ishte qenia e fundit e krijuar që u shfaq në Tokë pas shfaqjes së bimëve dhe kafshëve?

Merreni parasysh thënien e Allahut të Madhëruar: **"Ne i bëmë natën dhe ditën dy mrekulli. Natën e mbështollëm me errësirë, kurse ditës i dhamë ndriçim."** [Surja el-Isrā: 12]

Ky ajet thotë se Hëna, e cila është shenjë e natës, ka qenë e shndritshme, pastaj drita e saj është shuar.

Ky është në të vërtetë shpjegimi që sahabët i dhanë këtij ajeti fisnik. Imam Ibn Kethiri transmeton në Tefsirin e tij se Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Hëna

²⁷ Sahih el Xhami' (8188).

shkëlqente si dielli dhe duke qenë shenjë e natës, është errësuar."

Është e mahnitshme se si ky është saktësisht përfundimi që shkencë ka arritur tani, kur NASA ka publikuar në faqen e saj zyrtare dhe kanalën zyrtar: "Epoka e parë e jetës së Hënës ishte me shkëlqim dhe ishte ndriçuese."²⁸

Është vërtetuar me transmetim të vazhdueshëm se vetëm nëpërmjet duarve të këtij njeriu (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) kanë ndodhur të gjitha shenjat dhe të rejtat e së padukshmes, si dhe sekretet e panumërta të tokës dhe të Qiellit. Atij i zbriti Kurani dhe ai erdhi me atë që kishin ardhur profetët para tij dhe ai u mbështet nga Allahu e nuk vdiq derisa sheriati u plotësua dhe u përsos.

Prandaj, pranimi me siguri të plotë se ai ishte një profet është mjaft i arsyeshëm.

Mrekullitë e tij të lidhura me të fshehtën janë më shumë se një mijë dhe ata që treguan mrekullitë e tij janë shokët e tij: njerëzit më të sinqertë dhe më të drejtë pas tij.

Ajo që është vërtet e mahnitshme është se sahabët e vjetër kishin pranuar Islamin para se të shihnin mrekullitë e tij; ata e

²⁸ http://www.nasa.gov/mission_pages/LRO/news/vid-tour.html
<https://www.youtube.com/watch?v=UIKmsQqp8wY>

dinin se profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte i vërtetë dhe se ai kurrë nuk kishte gënjyer.

Ky qëndrim i sahabëve të vjetër është një qëndrim i mençur e logjik. Vërtetësia e Pejgamberit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) është e mjaftueshme dhe është një dëshmi e pavarur për të vërtetuar vlefshmërinë e profecisë së tij... Kjo, se personi që pretendon profecinë është më i sinqerti i njerëzve..., meqë profeti duhet të jetë më i sinqerti i njerëzve.

Ose, në të kundërtën ai do të ishte gënjeshtari më i keq në mesin e njerëzve, sepse trillon gënjeshtra për çështjet më serioze dhe më të rëndësishme.

Vetëm njerëzit më injorantë nuk janë në gjendje të bëjnë dallimin midis njeriut më të sinqertë dhe gënjeshtarit më të keq.²⁹

Sa e lehtë që është për një njeri të mençur të bëjë dallimin mes njeriut më të sinqertë dhe gënjeshtarit më të keq.

Që nga dita e parë e misionit të tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) politeistët e kanë pranuar se ai kurrë nuk ka gënjyer, pasi i kanë thënë: **"Nuk të kemi gjetur kurrë duke gënjyer."**³⁰

²⁹ Thubut en-Nubuvat aklen ue naklen, Ibn Tejmije, Dar Ibnul-Xhevzi, fq. 573, po ashtu fq. 318.

³⁰ Sahih el-Buhari (4971).

Kur Herakliu e pyeti Ebu Sufjanin para se të pranonte Islamin: "A e keni akuzuar atë për ndonjë gënjeshtër para se të thoshte atë që tha?" Ebu Sufjani tha: "Jo." Herakliu tha: "Ai nuk ka gënjyer për njerëzit, e lëre më të gënjejë për Allahun." Pastaj, Herakliu vazhdoi me thënien e tij të famshme: "Në qoftë se tash do të isha pranë tij, do t'ia pastroja këmbët atij."³¹

Jobsimtarët nuk ishin në gjendje të vërtetonin qoftë dhe një rast të vetëm të gënjeshtres gjatë gjithë jetës së tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe kjo është arsyeja pse Kurani i kritikoi ata për mosbesimin e tyre, pavarësisht se e dinin gjendjen e tij përpara misionit të tij. Zoti i Madhërishëm ka thënë: "**Apo ata nuk e kanë njohur të Dërguarin e tyre, prandaj e mohojnë atë?**" [Surja el-Muminun: 69]

Karakterit të dërguarit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) dhe sjellja e tij janë dëshmi e pavarur se ai është profet.

Kur sinqeriteti i përgjithshëm mbështet profecinë e tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!), atëherë si mund t'i mohojë një person i arsyeshëm të gjitha këto?

³¹ Sahih el-Buhari (7).

26. Si mund ta di se kërkohet prej meje ta besoj Allahun?

Përgjigjja: Shikoni brenda vetes. Do ta dini se jeni duke u testuar. A nuk keni një ndjenjë brenda jush duke ju thënë të bëni atë që është e drejtë dhe të mos bëni atë që është e gabuar?

Nëse para jush është një shumë e parave dhe pronari i saj nuk është duke iu kushtuar vëmendje, atëherë ju mund të keni ndjesinë e marrjes së këtyre parave dhe përfitimit prej tyre, si dhe ndjenjën e kundërt, duke ju thënë: “Mos e bëj këtë, sepse kjo është e ndaluar dhe është krim.”

Pra, ju jeni në sprovë në çdo situatë të jetës suaj.

Këtë ndjesi, - bëje dhe mos e bëj, - e ke brenda vetes, sepse vërtet je duke u testuar dhe nuk je lënë kot në këtë jetë. Ti nuk je diçka pa vlerë.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.”** [Surja el-Insan: 3]

Të pasurit e ndjenjës “bëj dhe mos bëj” do të thotë që një njeri ose do të jetë mirënjohës, ose mosmirënjohës në çdo aspekt të jetës së tij.

Prandaj, në çdo hap të jetës së tij ai ose mund të bëjë mirë, ose jo, pra, ose mund të shkojë në xhami, ose të merret me argëtim.

Për këtë, Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.”** [Surja edh-Dharijat: 56]

Në çdo hap, ju mund të shihni një formë të shërbimit ndaj Allahut ose të mosbindjes ndaj Tij.

Pra, ka shpëtuar kushdo që udhëzohet për të bërë atë që ka urdhëruar Allahu dhe ka humbur kushdo që nuk u bindet urdhrave të Tij.

Kjo aftësi për të zgjedhur nënkupton se njeriu do të llogaritet për të gjitha veprat e tij.

Qëllimi për të cilin jemi krijuar është që të sprovohemi dhe të testohemi, ky është qëllimi për të cilin Allahu dërgoi të dërguarit dhe zbriti shpalljet: **“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!”** [Surja en-Nahël: 36]

Dhe pas përfundimit të provës, ne i kthehemi Allahut: **“... tek i Cili do të ktheheni të gjithë?”** [Surja Jasin: 22]

“... se te Zoti yt do të jetë kthimi.” [Surja en-Nexhm: 42]

“Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!” [Surja el-Alek: 8]

Ne do të kthehemi tek Allahu për të dhënë llogari për atë që e kemi bërë. **“... se përpjekjet e tij do të shihen dhe se do të shpërblehet me shpërblim të plotë.”** [Surja en-Nexhm: 40-41]

Ju do të shihni veprat tuaja dhe do të merreni në llogari për to: **“... kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”** [Surja ez-Zelzele: 7-8]

27. A mjafton të besoj Allahun dhe të mos besoj profetët?

Përgjigjja: Jo.

Besimi në ekzistencën e Allahut, ndërsa mosbesimi në profetët, nuk mjafton që një person të jetë musliman. Çfarë do të thotë të besosh se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Drejtuesi i punëve, e pastaj të mos besosh në shpalljen e Tij dhe të mohosh të dërguarit e Tij?

Ky është mosbesim i madh.

Në fakt, nuk ka krim më të madh se refuzimi i shpalljes së Allahut. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit.”** [Surja en-Nisa: 150-151]

Pra, ai që beson në Allahun dhe nuk i beson peygamberët pa dyshim se është jobesimtar.

Kushdo që nuk beson në një nga peygamberët, në të vërtetë është jobesimtar sepse ai e mohon shpalljen e Allahut. Prandaj, ithtarët e Librit ishin jobesimtarë, sepse ata nuk besuan në profecinë e Muhamed ibn Abdullahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). **“Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e**

Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.” [Surja el-Bejjine: 6]

Kërcënimi që Allahu u bën atyre me hyrje në Zjarr është i vërtetë: **“... prandaj kundër tyre u përmbush dënimi Im.”** [Surja Kaf: 14]

As Islami nuk do të ishte i vlefshëm, as shpëtimi nuk do të arrihej thjesht duke pranuar se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Ai që jep jetë dhe shkakton vdekjen; përkundrazi, është thelbësore të besosh edhe në të dërguarit e Tij.

Prandaj, besimi në ekzistencën e Allahut dhe mosbesimi në pejgamberët nuk është i mjaftueshëm dhe nuk i bën dobi robit me Allahun në Ditën e Kiametit, pasi ai duhet ta adhurojë Allahun dhe të ketë besim në të gjithë të dërguarit e Tij.

Sikur të mjaftonte vetëm besimi në ekzistencën e Allahut, Allahu nuk do t'i dërgonte të dërguarit e Tij e as do t'i shpallte Librat e Tij, sepse të gjitha qeniet njerëzore e njohin Allahun me prijje natyrore.

Allahu, i Cili ju krijoi, ju udhëzoi dhe ju furnizoi, është i Vetmi që meriton të adhurohet ashtu siç ka thënë përmes të dërguarve dhe profetëve të Tij.

28. A ka shpërblim jobesimtari për veprat e tij të mira?

Përgjigjja: Allahu i ka krijuar njerëzit me prirje për të bërë vepra të mira. Prandaj, çdo person mund të bëjë vepra të mira, edhe nëse ai është jobesimtar ose politeist. Të gjithë njerëzit bëjnë vepra të mira për shkak të prirjes me të cilën janë krijuar.

Megjithatë, kushti për të pranuar një vepër të drejtë është që ajo të bëhet për hir të Allahut, pra, për të fituar nga Allahu shpërblimin e asaj vepre.

Për këtë arsye, atij që nuk beson Allahun dhe adhuron zota të tjerë me Të, ne i themi: “Shko tek ata të cilët i besove si zota përpos Allahut dhe merr shpërblimin e veprave të tua të mira prej tyre, sepse nuk kërkove për të kënaqur vetëm Allahun me këto vepra.”

Imagjinoni një person, familja e të cilit e rriti dhe shpenzoi për të derisa u bë i fortë, pastaj ky shkoi te të tjerët për t'u shërbyer atyre. A ka të drejtë të kthehet te familja e tij për t'u thënë atyre: “Më jepni pagën time që u shërbej të tjerëve?”

Le të shkojë tek ata të cilëve u ka shërbyer dhe të marrë rrogën prej tyre.

Allahut i takon shembulli më i lartë.

Allahu është Ai që ju krijoi, ju dha furnizim dhe ju dhuroi të gjitha begatitë tuaja, pastaj ju e lini adhurimin e tij dhe dëshironi të

merrni prej Tij shpërblimin për veprat tuaja? Si është e mundur kjo?

Për këtë arsye, Allahu ka thënë: **“Dhe Ne do t’u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t’i shndërrojmë në pluhur e hi.”** [Surja el-Furkan: 23]

Dhe, Ai po ashtu ka thënë: **“Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë.”** [Surja en-Nur: 39]

Ata që nuk besuan nuk meritojnë shpërblim për veprat e tyre, edhe nëse janë të mira, sepse ata janë jobesimtarë të cilët me veprat e tyre të mira nuk synuan të fitojnë shpërblimin e Zotit të tyre e as që kërkuan kënaqësinë e Krijuesit të tyre.

Pra, nuk është vetëm vepra e mirë ajo që ka rëndësi, sepse ne të gjithë jemi krijuar që natyrshëm të bëjmë vepra të mira. Por, çështja është pse e bëni këtë vepër të mirë dhe për kë bëni? A e bëni atë për interesin tuaj, për popullaritet, apo për dikë tjetër përveç Allahut?

Gjithë kjo nuk bëhet për hir të Allahut, kështu që, nga këto vepra të mira nuk pritet shpërblimi i cili pritet nga veprat e mira që bëhen për hir të Allahut.

29. Në qoftë se Islami është fe e vërtetë, atëherë pse ka shumë keqkuptime?

Përgjigjja: Keqkuptimi në fe është një çështje që muslimani nuk e kupton dhe mund t'i shkaktojë konfuzion derisa të gjejë një përgjigje për të.

Allahu i Madhëruar ka dashur që në disa çështje dytësore të Islamit të ketë disa çështje të paqarta, në mënyrë që njerëzit e pasinqertë të tregojnë mosbindjen e tyre ndaj Zotit për shkak të çështjeve të tilla.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (vargje) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve piren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t’i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni, thonë: “Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!” Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.”** [Surja Al-Imran: 7]

Ata që kanë zemra të devijuara do të ndjekin ide të tilla të gabuara, për të kërkuar fitne dhe për t'u larguar nga Allahu.

Allahu me urtësinë e Tij ka dashur që në mes të njerëzve të ketë besim dhe mosbesim. **“... disa prej jush janë mohues e disa besimtarë.”** [Surja Taghābun: 2]

Ata që dëshirojnë mosbesimin, bëhen të lidhur me këto keqkuptime dhe preokupohen prej tyre, duke qëndruar larg fesë, lutjeve dhe besimit të tyre.

Sa i përket besimtarit, ai ndjek dëshminë e prerë (Librin) mbi vlefshmërinë e fesë dhe vlefshmërinë e mesazhit. Nëse ai gjen diçka që nuk e kupton, ai pyet për të, por kurrë nuk shpërqendrohet nga feja ose namazi i tij duke u nisur nga ajo që nuk kupton.

Vetëm ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre shpërqendrohen nga feja e tyre për shkak të asaj që nuk e kuptojnë. **“... dhe që të thonë ata që kanë sëmundjen e dyshimit në zemër dhe jobesimtarët: “Ç’ka dashur të thotë Allahu me këtë shembull?” Kështu, Allahu lë në humbje atë që do dhe çon në rrugë të drejtë atë që do.”** [Surja el-Mudethir: 31]

Urtësia e ekzistimit të keqkuptimeve të tilla vihet në pah edhe me faktin se për shkak të këtyre çështjeve të paqarta, njerëzit e dijes janë të pozitave të ndryshme, gjegjësisht ai që ka dituri e di përgjigjen për çështje të tilla të paqarta dhe për shkak të kësaj dallohet nga një person i zakonshëm që nuk ka njohuri të thella për fenë dhe as që e ka studiuar atë. Pra, Allahu do t'i ngrejë në shkallë ata që kanë dije.

E vërteta është e qartë si kristal, por keqkuptimet janë thelbësore, sepse përmes tyre verifikohet besimi i besimtarëve.

Norma e vendosur e Allahut në krijesën e Tij është detyra që ata kanë, dhe norma e Tij në këto detyra është fshehja e disa urtësive. Person i suksesshëm është ai që përdor atë që di për të konkluduar atë që është e fshehtë dhe delikate, ndërsa i pasuksesshëm është ai që e merr injorancën e tij si një perde që e privon atë që ta bëjë diturinë një mënyrë për të nxjerrë përfundimin për atë që ai nuk e di.

30-Pse Allahu ka krijuar të keqen? Me fjalë të tjera, cila është përgjigjja e muslimanit për dilemën e ekzistimit të së keqes?

Në përgjithësi, paradoksi i së keqes është shkaku kryesor i ateizmit përgjatë historisë.

“Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo është humbja e qartë.” [Surja el-Haxh: 11]

Ka nga ata që nuk besojnë Allahun për shkak të ndonjë sprove ose fatkeqësie që i godet.

Këtu, një ateist mund të pyesë: Pse ekziston e keqja në radhë të parë?

Thjesht, përgjigjja është se ne jemi nën caktimin fetar.

Sepse jemi në një botë sprovash.

Zoti ynë i Lartësuar ka thënë: **“Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë.”** [Surja el-Enbija: 35]

E mira dhe e keqja ekzistojnë sepse ju jeni të lidhur me caktimin fetar, që është qëllimi i ekzistencës suaj.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i Madh.”** [Surja el-Mulk: 2]

Ekzistenca e së keqes, sprovave dhe fatkeqësive është në vetvete dëshmia më e madhe e vlefshmërisë së çështjes së fesë dhe gabimit të ateizmit.

Nëse do të ishim fëmijët e botës materiale, nuk do ta kuptonim as të mirën e as të keqen.

Nëse gjithë universi do të ishte i pakuptimtë, ne nuk do ta perceptonim fare se është i pakuptimtë.³² Sepse, sipas pikëpamjes ateiste, ne ndjekim rregulla të rrepta materiale dhe për ne zbatohen ligjet e natyrës. Në këtë kontekst, ne nuk do të kuptonim as thelbin e së keqes e as kuptimin e fjalës “e keqe”.

Pra, a e perceptojnë kafshët më të sofistikuar paradoksin e së keqes?

³²C. S. Lewis

Në fakt, të kuptuarit e së keqes do të thotë se ne nuk jemi fëmijë të kësaj bote materialiste dhe se ne e marrim të kuptuarit tonë për ekzistencën e së keqes nga një premisë tjetër përveç premisë darviniste e materialiste të ekzistencës.

Në vend të kësaj, ne i përkasim një premise hyjnore, jo një modeli materialist, ateist tokësor dhe ky është i vetmi shpjegim pse ne e dimë kuptimin e së keqes.

Përderisa jemi të ngarkuar me caktimin fetar është e natyrshme që të ketë sprovë dhe mundime, ndërkaq është e natyrshme që ne të dimë kuptimin e së keqes.

E keqja, disa dhimbje dhe aftësia për të kryer mosbindje është e natyrshme dhe rezultat i vetëdëshmisë së vullnetit të lirë dhe caktimit hyjnor.

Ekzistenca e së keqes, fatkeqësive dhe dëshirave zbulon më të mirën e një personi të mirë dhe më të keqen e një personi të korruptuar.

Është për t'u habitur që ateistët e mohojnë ekzistencën e Krijuesit sepse ekziston e keqja. Ata përdorin analizën e mëposhtme:

1-Nëse babai është dashamirës dhe pëlqen të mirën për djalin e tij, atëherë pse e ka lejuar që t'i bëhet një injeksion i dhimbshëm kundër mikrobeve?

2-A vuan djali nga dhimbja si pasojë e injektimit?

3-Atëherë, babai nuk ekziston.³³

Por, a është kjo një analizë logjike?

Për më tepër, është e natyrshme që ne nuk i kuptojmë të gjitha hollësitë e urtësisë hyjnore për të mirën dhe të keqen.

Allahu ka zbuluar urtësinë e veprimeve të Hidrit me Musain (paqja qoftë mbi ta!), edhe pse ato janë veprime që në dukje janë të papranueshme, por ato përfshijnë të mira të shumta. Gjithashtu, historia e Musait dhe Hidrit nuk u përmend në Kuran si një formë tregimi ose storie, por si një çështje reflektimi dhe njohjeje e mangësive të shpirtit njerëzor dhe gjykimit të tij të nxituar.

Ajo që është edhe më e habitshme për çështjen e së keqes është se, po të mos kishte të keqe në botë, nuk do të largohesh nga vendi ku ke lindur!

Asnjë qytetërim nuk do të kishte ekzistuar, as qytete, fabrika e shtëpi nuk do të ndërtoheshin, njerëzit nuk do të kishin nevojë për punë, as njerëzit nuk do të mendonin t'i rezistonin një sëmundjeje, të zgjidhnin një problem ose të shpiknin një ide për t'u sjellë komoditet!

Në radhë të parë, as do të kishte nevojë që një person të lëvizte nga vendlindja e tij, sepse nuk do të kishte asnjë të keqe, asnjë

³³ Shih: Usus gaibeh, Ahmed Hasen, Merkez Delail.

telash, asnjë mundim, asnjë lodhje dhe asnjë problem për të cilin duhet të kërkojmë zgjidhje!

Pra, pse të mundohesh të rrish deri vonë, të mendosh dhe të punosh?

E keqja është një domosdoshmëri në këtë botë!

Mendoni rreth kësaj!

Dhe kini ndërgjegjen për Allahun, sepse juve ju është caktuar një detyrë.

Shumë njerëz kalojnë nëpër fatkeqësi dhe ligësi, pastaj kthehen tek Allahu dhe bëhen të drejtë. Lavdia i takon Allahut, më të Madhit, dhe lavdërimi i takon Atij.

Ka urtësi dhe mirësi në të gjitha caktimet e Allahut.

Një musliman duhet të besojë në të gjitha caktimet e Allahut. Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Sikur të kishit aq ar sa mali Uhud, të cilin e shpenzoni në rrugën e Allahut, kjo nuk do t'ju pranohej derisa të besoni në caktimin hyjnor dhe derisa ta dini se çfarëdo që ju ka ndodhur juve, nuk keni mundur ta shmangni; dhe çfarëdo që nuk ju ka ndodhur, nuk ka mundur t'ju ndodhë; dhe se nëse do të vdisje duke besuar diçka tjetër përveç kësaj, do të hyje në Xhehenem."³⁴

³⁴ Sahih Sunan Ebi Davud (4699).

Muslimanit i kërkohet të pranojë caktimin e Allahut, me aspektet e tij të mira dhe të këqija.

Në fakt, të gjitha caktimet e Allahut janë të mira, edhe nëse disa prej tyre nga pamja e jashtme duken të këqija, shqetësuese ose të dëmshme, por në fund ato përfshijnë të mira të mëdha dhe urtësi të shumta hyjnore.

31. A ka qenë feja shkaktar i të gjitha luftërave fetare që e kanë dominuar botën në kohën e shkuar?

Përgjigjja: Njerëzimi ka jetuar me ligjet e monoteizmit për mijëra vjet, dhe me tri ligjet e mëdha abrahamike për katër mijë vjet. Gjatë kësaj kohe, feja nuk përfaqësonte një kërcënim të drejtpërdrejtë për racën njerëzore, përkundrazi, ajo i paraqiste njerëzimit vlerat më të larta morale, për të cilat si besimtari, ashtu dhe ateisti, bien dakord dhe sipas tyre kanë krijuar më tej qytetërimi të vërteta.

Ne mund të argumentojmë se çdo e mirë që ekziston në tokë është një nga efektet e atyre profecive! Feja i ka lehtësuar gjykimet e mijëra çështjeve dhe mbi të gjitha, feja hodhi themelet e dijes, sjelljes dhe vlerave, me qëllim që njerëzimi të ekzistonte në tokë! Vendet që përfaqëuan ligjet monoteiste kanë ende diversitet kulturor që i ka mbrojtur kundërshtarët e tyre dhe u siguroi atyre një çati mbrojtjeje sipas vetë ligjeve monoteiste.

Nga ana tjetër, në kohën kur disa vende iu afruan ateizmit, gjithë njerëzimi ishte në prag të shkatërrimit brenda vetëm një shekulli, ndërsa tash vijnë ateistët dhe na flasin për rrezikun e fesë për njerëzimin!

Historia njerëzore nuk ka njohur ende një metodologji më të rrezikshme se ateizmi. Masakrat e Gulagut në ish-Bashkimin Sovjetik nga ateisti Lenin, shfarosja e pakicave etnike në Gjermaninë naziste, zhdukja e një së katërtës së popullsisë kamboxhiane nga ateisti Pol Pot, vrasja e 52 milionë kinezëve në Revolucionin e Madh Kulturor nga duart e ateistit Mao Ce Dun, dhe shfaqja e Lidhjes së Ateistëve Militantë në Evropë, e cila mbylli zyrtarisht 42 mijë institucione fetare, përfshirë kisha e xhami, dhe vrau dhjetëra mijëra njerëz fetarë, të gjitha këto ishin pasojat dhe rezultatet e natyrshme të shfaqjes së ateizmit.³⁵

Përkundrazi, Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore ishin luftëra ateiste të qeverisura nga perceptimet ateiste të racave njerëzore dhe idetë e përpjekjes për pastërtinë racore. Rezultati ishte shfarosja e rreth 5% të popullsisë së botës.

Luftërat botërore shkaktuan përkeqësimin e gjendjes së të dymë: fitimtarëve dhe të të mundurve, të cilët i ktheu prapa për një të tretën e shekullit. Për këtë, filozofët vendosën një nevojtoje në mes të Parisit si një metaforë për fundin e qytetërimit.

³⁵ https://en.wikipedia.org/wiki/League_of_Militant_Atheists

Betejat ateiste kanë lënë arsenale të armëve bërthamore që janë të mjaftueshme për të shfarosur tërë racën njerëzore. Në fakt, një analizë e thjeshtë e luftërave të shekullit të njëzetë tregon se sa i mjerë është ateizmi. Ateizmi ka lënë pas një koncept që zhdukja e racës njerëzore në çdo betejë të ardhshme është një ide e vlefshme, dhe i tillë është rezultati i pritshëm ateist.

32. Pse muslimanët janë goditur nga prapambetja përkundër fesë së tyre monoteiste, ndërkohë që Perëndimi është kaq i avancuar?

Përgjigjja: Këtu është në pyetje qytetërimi!

Profetët kanë vuajtur shumë përballë kësaj pyetjeje dhe kjo ka bërë që shumë njerëz t'i braktisnin ata.

Çështja e qytetërimit është origjina e mosbesimit të kombeve përgjatë epokave.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Kur u lexohen vargjet Tona të qarta, jobesimtarët u thonë atyre që kanë besuar: “Cili grup ka pozitë më të mirë dhe rreth më të mirë?”** [Surja Merjem: 73]

Kur u recituan ajetet që përfshijnë prova dhe evidencë të korrektësisë së fesë, jobesimtarët përdorën përparimin e popujve jobesimtarë si argument për t'i kundërshtuar këto vargje. "Cila nga dy palët është më e mirë për sa i përket vendbanimeve dhe cila është superiore në përfitimet shoqërore?"

Studiuesi Ibrahim es-Sekrani (Allahu e ruajttë!) thotë: "Kjo është historikisht e vërtetë dhe një normë. Është për t'u habitur se si vazhdon gjatë gjithë epokave. Shumica e atyre që janë informuar për Allahun që nga fillimi i profecisë e deri më sot. Predikimet islame gjithmonë janë ballafaquar me "forca materiale" që synojnë t'i tejkalojnë ato dhe t'i tërheqin njerëzit larg ndjekjes së shpalljes.

Shikoni përvojat e profetëve, do të zbuloni se pothuajse të gjithë përfaqësojnë një histori që flet për konfliktin midis thirrësit në "shpalljen hyjnore" dhe tundimit të "forcave materiale". Do të zbuloni se të gjithë ata që punojnë për fenë kanë vështirësi të mëdha për shkak të pasionit të njerëzve me manifestimet materiale. Njerëzit e profetit të parë, Nuhut (paqja qoftë mbi të!), i thanë atij tërë çiltërsinë materiale: **"... dhe, shohim, që ty të shkojnë pas vetëm më të pavlerët nga ne, pa menduar fare. Ne nuk shohim se ti ke diçka më të mirë se ne, madje ju quajmë gënjeshtarë."** [Surja Hud: 27]

Më pas, sapo u shfaq profeti i Allahut, Musai, një varg tiranie dhe arrogance nga pushteti civil u orkestrua kundër shpalljes. **"Musai tha: "O Zoti ynë! Ti i ke dhënë Faraonit dhe parisë së tij stoli dhe pasuri në jetën e kësaj bote, por ata, o Zoti ynë, na largojnë nga rruga Jote! O Zoti ynë! Shkatërroje pasurinë e tyre dhe ngurtësoji zemrat e tyre, që të mos besojnë, derisa të shijojnë dënimin e dhembshëm!"** [Surja Junus: 88]

Një situatë e tillë nuk ishte asgjë e re për profetin tonë Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), pasi ata që refuzuan profecinë dhe shpalljen e tij, po përpiqeshin të përdornin dobësinë e tij materiale si arsyetim për t'u larguar prej tij. **“Sikur t’i kishte zbritur ky Kuran ndonjë njeriu të madh prej njerit nga këto dy qytete.”** [Surja ez-Zuhruf: 31]

Këtu mbarojnë fjalët e Ibrahim es-Sekranit.

Gjatë gjithë epokave dhe historisë së profecisë, njerëzimi nuk është goditur nga një fatkeqësi më e madhe sesa magjepsja nga fuqia materiale e jobesimtarëve, edhe pse në radhë të parë nuk ka asnjë lidhje ndërmjet përparimit dhe së vërtetës.

Në fakt, përparimi material dhe prapambetja nuk kanë të bëjnë fare me atë se kush ka të drejtë dhe kush e ka gabim.

Që një person të jetë i virtytshëm dhe i drejtë, ai nuk duhet medoemos të jetë i qytetëruar.

Një person mund të jetë një musliman i devotshëm, megjithëse i varfër dhe i thjeshtë, dhe anasjelltas.

Shumë kombe kanë qenë të përparuara në qytetërim, por më të largët nga ligji, feja dhe shpallja e Allahut. **“Vallë, a nuk udhëtojnë nëpër botë e të shohin se si kanë përfunduar popujt e mëparshëm? Ata kanë qenë më të fortë se këta dhe tokën e kanë shfrytëzuar dhe punuar më mirë se sa e punojnë këta, e të dërguarit e tyre u kanë sjellë prova të qarta. Nuk ishte Allahu**

që u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes padrejtësi...”

[Surja er-Rrum: 9]

Progresi material dhe pasuria financiare nuk janë kriter për të definuar se kush i përmbahet së vërtetës. **“Kur të dërguarit e tyre iu sollën prova të qarta, ata u mburrën me diturinë që zotëronin vetë; por shumë shpejt i goditi ajo, me të cilën talleshin.”** [Surja Gafir: 83]

Pra, përparimi material nuk lavdërohet në vetvete e as përçmohet. Përkundrazi, ajo është e lavdëruar aq sa duhet nga shpallja hyjnore dhe sipas masës në të cilën feja zbatohet, sa përfitohet prej saj në fe dhe si përdoret për t'u sjellë dobi dhe përmirësim të kushteve të njerëzve për hir të Allahut.

Ky është progresi i kërkuar.

Kriteri i vërtetë për përsosurinë midis qenieve njerëzore nuk është në përparimin e tyre material, por në shkallët e tyre të ndryshme të devotshmërisë dhe të veprave të drejta. Përparimi material vjen si mjet dhe jo si qëllim... Ai vjen si mjet për t'u shërbyer dhe për t'u sjellë dobi njerëzve për hir të Allahut.

Kështu, ky është i vetmi përparim material i kërkuar, sepse lavdërohet nga shpallja hyjnore. Kjo është trashëgimia e vërtetë në tokë: trashëgimia që bazohet në robërinë ndaj Allahut dhe lidhjen e pastër me besimin në të gjitha aspektet e jetës. **“... nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zekatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që**

është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.” [Surja el-Haxh: 41]

Dhe dije se, nëse muslimani bën atë që i kërkohet, Allahu do t'ia lehtësojë arritjen e të gjitha të mirave, lumturisë, përparimit në këtë botë, si dhe shpëtimin e ngritjen e gradës në botën tjetër.

“Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim).” [Surja en-Nur: 55]

Kur muslimanët zbatonin fenë e tyre, ata ishin udhëheqës në çështjet fetare dhe të çështjeve të kësaj bote.

Nga duart e tyre Islami si qytetërim zgjati 1200 vjet, qytetërim ky më i gjatë dhe që vazhdoi pa ndërprerje gjatë gjithë kësaj periudhe.

Feja islame ishte themeluese e qytetërimit islam.

Kështu, Islami është e vetmja fe që themeloi një qytetërim, kurse fetë e tjera u përqaftuan nga qytetërimet.

Për shembull, qytetërimi perëndimor përqaftoi krishterimin dhe qytetërimi indian përqaftoi hinduizmin.

Ndërkaq, feja e vetme që themeloi një qytetërim është Islami.

Kur muslimanët ishin të vetëdijshëm për atë që u kërkohet të bëjnë në lidhje me fenë e tyre, ata udhëhoqën botën materialisht dhe shpirtërisht.

Kur Islami hyri në Kostandinopojë në vitin 1453, Mesjeta e Errët e Evropës mori fund. Në fakt, data e fundit të epokës së errët është viti 1453, i njëjti vit kur Islami hyri në Evropë. Sapo Islami hyri në zemër të Evropës, në të shkëlqeu drita e diturisë.

Në Bibliotekën e Kongresit, në tavanin e sallës kryesore të bibliotekës janë gdhendur rrathët për të treguar burimet e përparimit të qytetërimit perëndimor dhe Islami është feja e vetme e përmendur në shtatë rrathët.

Islami është feja e vetme e përmendur, si e lidhur me shkencat natyrore.

ISLAMI: FIZIKA

Ndërkaq, pjesa tjetër e rrathëve përmend emrat e vendeve dhe atë që këto vende kanë kontribuar në përparimin letrar, artistik ose gjuhësor!

Megjithatë, Islami e prezantoi shkencën dhe për shtatëqind vjet gjuha ndërkombëtare e shkencës në botë ishte arabishtja.³⁶

³⁶

<https://www.telegraph.co.uk/news/science/science-news/3323462/Science-Islams-forgotten-geniuses.html>

Nëse muslimanët e rregullojnë fenë e tyre, jeta e tyre e kësaj bote do të rregullohet (po ashtu).

33. Cilat janë dobitë e adhurimit të Allahut të Lartësuar?

Përgjigjja: Njeriu, nga natyra, nuk mund ta njohë veten e tij, nuk mund të shijojë qetësinë e shpirtit e as zemra e tij nuk mund të qetësohet përveçse duke adhuruar Allahun: **“... ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** [Surja er-Rrad: 28]

Adhurimi e qetëson shpirtin: **“Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre, andaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur!”** [Surja el-Hixhër: 97-98]

Adhuroni Zotin tuaj, ashtu që zemra juaj të qetësohet.

Prandaj, falja e dy rekateve me përkushtim e nënshtrim i bën shpirtit të njeriut atë që orët e seancave qetësuese psikologjike nuk arrijnë ta bëjnë.

Vërtet, adhurimi i jep qetësi shpirtit të njeriut dhe kushdo që është i larguar nga kujtimi për Allahun, ai njeri vuan nga shqetësimi dhe do ta gjesh atë gjithmonë të pasionuar për përfitime të kësaj bote, ani pse ai nuk është as i ngopur e as i qetë. **“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar.”** [Surja Taha: 124]

Pavarësisht se sa i pasur mund të jetë një person, pa besim ai do të ketë një jetë të vështirë dhe do të përfshihet në një garë të furishme e të pafundme me të panjohurën, kështu që do ta shihni gjithmonë në ankth.

Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë:

"Kushdo që është i përqendruar në botën tjetër, Allahu do t'ia pasurojë zemrën, do t'ia zgjidhë punët atij dhe të mirat e kësaj bote do t'i vijnë të nënshtruara. Ndërsa, kush është i përqendruar vetëm në jetën e dynjasë, Allahu do t'ia vërë varfërinë para syve, do t'ia ngatërrojë punët e tij dhe ai do të ketë nga kjo botë vetëm atë që i është caktuar atij."³⁷

Adhurimi e çliron muslimanin nga nënshtrimi ndaj jetës së kësaj bote dhe e bën atë të lirë.

Prandaj, një musliman që vërtet e adhuron Allahun, është një person që e kupton domethënien e jetës, vlerën e kësaj bote, qëllimin e ekzistencës së tij në këtë botë dhe e kupton se ai është në këtë botë për t'u sprovuar, e për ta adhuruar Zotin e tij dhe jo për të jetuar kot në ankth. Zoti ynë i Madhërishëm ka thënë: **“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë.”** [Surja el-Mulk: 2]

³⁷ Sahih Sunen et-Tirmidhi (2465).

34. Si manifestohet nënshtrimi ndaj Allahut të Plotfuqishëm? Ose, me fjalë të tjera, si e di që i je nënshtruar plotësisht Allahut?

Përgjigjja: Janë katër sinjale të nënshtrimit ndaj Allahut të Plotfuqishëm:

Së pari: Demonstrimi i shërbimit për Allahun në çdo çështje, të madhe ose të vogël, në jetën tënde. Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: **“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.”** [Surja el-Enam: 162-163]

Lutja ime, sakrifica ime, jeta ime dhe vdekja ime janë të gjitha për Allahun: gjithçka që bëj, e bëj për Allahun; i lutem Allahut, u bindem prindërve për Allahun, studioj dhe mësoj për të përfituar njerëzit për hir të Allahut. Unë fle në mënyrë që të kam energji në mëngjes për të bërë atë që Allahu më ka urdhëruar.

Shërbimi ndaj Allahut përfshihet në çdo vepër timen. Ky është manifestimi i parë dhe shenjë e nënshtrimit ndaj Allahut.

Shenja e dytë: Për të qenë plotësisht i nënshtruar ndaj Allahut, duhet të pajtohesh me atë që Allahu ka urdhëruar dhe të shmangësh atë që Ai e ka ndaluar. Zoti ynë, i Lartësuar, ka thënë: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos ia ktheni shpinën, ndërkohë që e dëgjoni (të vërtetën)!”** [Surja el-Enfal: 20]

Allahu i Plotfuqishëm ka thënë po ashtu: **“O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij.”** [Surja el-Bekare: 208]

Pra, pajtohuni me gjithçka që Allahu ka urdhëruar dhe përmbahuni nga ajo të cilën Ai e ka ndaluar.

Kur Allahu më urdhëron për të bërë diçka, unë duhet ta bëj atë, e, kur Ai më ndalon ndonjë gjë, unë përmbahem. Ky është nënshtrimi i plotë dhe dorëzimi për Allahun.

Shenja e tretë e nënshtrimit ndaj Allahut është referimi i gjykitimit në ligjin e Allahut me vullnet dhe pranueshmëri.

Ne e pranojmë tërë legjislacionin e shenjtë dhe nuk e mohojmë, për shembull, dënimin të cilin Allahu e ka bërë të ligjshëm. Përkundrazi, ne duhet të jemi të kënaqur me ligjin e Allahut, sepse Allahu e di se çka është e drejtë për krijesat e Tij dhe e di që këto dënime e pastrojnë shoqërinë. (A nuk e njeh Ai krijimin e Vet, ndërsa Ai është më i Dijshmi?)

Allahu i Plotfuqishëm po ashtu ka thënë: **“E kush është gjykatës më i mirë se Allahu?”** [Surja el-Maide: 50]

Allahu është Ai i Cili e di se çka është më e mira për njerëzit në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Zbatimi i ligjit të Allahut i pastron njerëzit dhe i bën ata të jetojnë në paqe.

Një njeri i cili thoshte se është besimtar në Allahun dhe në atë që i ishte shpallur Profetit (paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) shkoi te një hebre, i cili quhej Ka'b ibnul-Eshref, për ta gjykuar atë për një rast, në vend se të shkonte tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi qofshin mbi të!), sepse kishte frikë se i Dërguari i Allahut do të mund të vendoste diçka që nuk i shkonte përshtat këtij. Kështu, ai shkoi te hebreu, duke shpresuar në vendim që i përshtatej, ndërsa Allahu i Plotfuqishëm shpalli: **“A nuk i ke parë ti (o Muhamed!) ata (hipokritë) që pohojnë se kanë besuar në atë që të është shpallur ty dhe profetëve të tjerë para teje? Ata kërkojnë gjykimin e zotave të rremë, ndërkohë që janë urdhëruar t’i mohojnë ata. Djalli dëshiron që t’i nxjerrë ata krejtësisht nga udha e drejtë.”** [Surja en-Nisa: 60]

Nëse je musliman që i nënshtrohesh Allahut, atëherë duhet t’i përmbahesh ligjit të Allahut dhe ta pranosh gjykimin e Tij me bindje të plotë, edhe nëse ky gjykim është kundër dëshirës sate, e të mos e lësh ligjin e Allahut e të shkosh te një çifut që të gjykojë rastin tënd dhe të të kënaqë me këtë gjykim.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t’u binden atyre.”** [Surja en-Nisa: 64]

Allahu nuk i dërgoi peygamberët që ne t’i lëmë ata dhe të kërkojmë gjykimin e të tjerëve. Përpos kësaj, Allahu i Madhëruar e përmbyll mësimin nga kjo ngjarje me një ajet të rëndësishëm që tregon domosdoshmërinë e nënshtimit ndaj ligjeve të Tij,

duke thënë: **“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjyqimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.”** [Surja en-Nisa: 65] Pra, është domosdoshmëri të bindemi ndaj ligjit të Allahut, sepse kjo është shenjë e paktimit tonë me Islamin.

Sa i përket shenjës së katërt të nënshtrimit ndaj Allahut të Madhëruar, ajo është: nënshtrimi ndaj caktimit të Allahut, sepse çdo gjë është e paracaktuar nga Allahu i Madhëruar me urtësinë e Tij. Prandaj, muslimani i nënshtrohet Allahut në të gjitha vendimet e Tij, në të mirë dhe në të keqe.

Kur muslimanit i ndodhin gjëra të mira, ai është mirënjohës ndaj Zotit të tij dhe, kur e godet fatkeqësia, ai bën durim.

Nëse Allahu ju siguron ushqim, furnizim të mirë, shtëpi të bukur, sukses në studime, trup të shëndetshëm ose familje të sjellshme, duhet ta falënderoni Allahun.

Nga ana tjetër, nëse një musliman është i prekur nga sëmundje, varfëri, frikë, sprovë ose pikëllim, ai duhet të tregojë durim për këto shqetësime dhe të kërkojë ndihmën e Allahut. Kështu është sjellja e një muslimani që i është nënshtruar Zotit të tij të Lartësuar.

Çdo gjë bëhet me paracaktimin e Allahut të Lartësuar: shëndeti, sëmundja, pasuria dhe varfëria... çdo gjë ndodh me paracaktimin

dhe urtësinë e Tij. Muslimani duhet të jetë i kënaqur me vendimet, sepse Allahu është Ai që i vendos ato.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar.”** [Surja el-Kamer: 49]

Ai, po ashtu, ka thënë: **“Thuaj: “Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu.”** [Surja et-Teube: 51]

Vetëm ajo të cilën e ka caktuar Allahu do të na ndodhë. Ai, i Lartësuari, ka thënë: **“Çdo shpirt vdes vetëm me vendimin e Allahut, në kohë të caktuar.”** [Surja Al-Imran: 145]

Allahu e ka caktuar edhe gjatësinë e jetës sonë. Gjithçka në univers, çdo atom që lëviz në këtë botë, gjithçka ndodh në pajtim me dijen dhe dëshirën e Allahut, me mençurinë dhe caktimin e Tij.

Zoti ynë i Lartësuar ka thënë: **“Sunduesi i qiejve dhe i Tokës, i Cili nuk ka bir e nuk ka ortak në pushtet; i Cili ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet!”** [Surja el-Furkan: 2]

Allahu i Madhëruar krijoi çdo gjë dhe paracaktoi çdo gjë. Çfarëdo që Ai ka dashur, tashmë ka ndodhur. Çfarëdo që Ai nuk ka dashur, nuk ka ndodhur kurrë.

Duke qenë musliman, nga unë kërkohet të pranoj me dëshirë gjithçka që është caktuar nga Allahu i Plotfuqishëm. Në këtë mënyrë, njeriu bëhet musliman duke iu nënshtruar Allahut.

Në fund, si mund ta pranoj Islamin?

Islami është feja që Allahu e ka caktuar për të gjithë njerëzimin. Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: **“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.”** [Surja Al-Imran: 19]

Nga të gjitha religjionet, Islami është feja e vetme të cilën Allahu e pranon: **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”** [Surja Al-Imran: 85]

Prandaj çdo person duhet ta pranojë Islamin. Në Islam ka shpëtim nga Zjarri, ka arritje të kënaqësisë së Allahut dhe ka Xhenet.

Hyrja në Islam është një nga begatitë më të mëdha; është çështja më e rëndësishme dhe më domethënëse në ekzistencën tuaj.

Në thelbin e tij, Islami është një kthim në dispozitat e natyrshme dhe kthim në arsye.

Hyrja në Islam është e lehtë dhe nuk kërkon rituale ose çështje zyrtare, njeriu duhet të thotë vetëm dy dëshmitë e besimit, duke thënë: “Eshhedu en la ilahe ilallah, ue eshhedu enne Muhemedan resulullah (Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përpos Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.)”

Duke thënë këtë, ai bëhet musliman dhe fillon të praktikojë Islamin.

Unë rekomandoj të ndiqni faqen e internetit **Islamhouse**, në gjuhën tuaj, në mënyrë që muslimani i ri të mësojë se si ta praktikojë Islamin...

Linku i faqes: <https://islamhouse.com/sq>

Titulli i originalit:
Islam and Atheism face to face

Autor:
Dr. Hejthem Talat

Përktheu:
Gëzim Zeqiri

Redaktor gjuhësor:
Jeton Koqinaj

Redaktor profesional:
Jusuf Kastrati

Kopertina:
Fatlum Zeka

Botoi:
Instituti Germa